

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA TIRANE**



**PROJEKTI: STUDIM - PROJEKTIM  
“NDËRTIMI RRUGËS “ZEF SEREMBE”**

**RAPORT TEKNIK**

**FAZA : PROJEKT ZBATIMI**

**DHJETOR 2023**

**PERGATITUR NGA BOE: SEED CONSULTING & ATELIER 4**



## PERMBAJTJA

|           |  |           |
|-----------|--|-----------|
| <b>1</b>  | <b>INFORMACION I PERGJITHSHEM MBI PROJEKTIN .....</b>                        | <b>4</b>  |
| 1.1       | <i>Informacion i per gjithshem.....</i>                                      | 5         |
| 1.2       | <i>Qyteti I Tiranes .....</i>  | 5         |
| <b>2</b>  | <b>OBJEKTIVAT E STUDIMIT .....</b>   | <b>7</b>  |
| 2.1       | <i>Qellimi i Pergjithshem .....</i>  | 7         |
| 2.2       | <i>Kuptimi i Detyres se Projektimit.....</i>                                 | 7         |
| <b>3</b>  | <b>IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT.....</b>   | <b>9</b>  |
| 3.1       | <i>Vizitat ne terren dhe grumbullimi i informacionit paraprak.....</i>       | 9         |
| 3.2       | <i>Foto te gjendjes ekzistuese .....</i>                                     | 9         |
| 3.3       | <i>Pershkrimi i gjendjes ekzistuese .....</i>                                | 11        |
| <b>4</b>  | <b>MBLEDHJA E KESHILLIT TEKNIK .....</b>                                     | <b>13</b> |
| 4.1       | <i>Vendimi i Keshillit Teknik.....</i>                                       | 13        |
| <b>5</b>  | <b>RILEVIMI TOPOGRAFIK .....</b>   | <b>14</b> |
| 5.1       | <i>Te per gjithshme.....</i>   | 14        |
| <b>6</b>  | <b>STUDIMI GJEOLOGJIK .....</b>  | <b>15</b> |
| 6.1       | <i>Ndertimi Gjeologjik - Harta Gjeologo-Inxhinierike .....</i>               | 15        |
| 6.2       | <i>Ndertimi gjeologjik – harta gjeologo-inxhinierike .....</i>               | 15        |
| <b>7</b>  | <b>STUDIMI HIDROLOGJIK .....</b>   | <b>18</b> |
| 7.1       | <i>Klima .....</i>   | 18        |
| 7.2       | <i>Zona klimatike .....</i>  | 18        |
| 7.3       | <i>Temperatura .....</i>   | 19        |
| 7.4       | <i>Mjegullat.....</i>  | 20        |
| 7.5       | <i>Reshjet.....</i>  | 20        |
| 7.6       | <i>Sistemi i kullimit.....</i>   | 21        |
| 7.7       | <i>Sistemi i furnizimit me ujë.....</i>                                      | 21        |
| 7.8       | <i>Të dhënat hidrologjike .....</i>  | 22        |
| 7.9       | <i>Reshjet maksimale.....</i>  | 22        |
| 7.10      | <i>Formulat baze ne llogaritjet hidraulike te sistemit te kullimit .....</i> | 24        |
| <b>8</b>  | <b>PROJEKTIMI I RRUGES .....</b>   | <b>26</b> |
| 8.1       | <i>Standartet Rrugore te Projektimit.....</i>                                | 26        |
| 8.2       | <i>Klasifikimi rrugor .....</i>  | 26        |
| 8.3       | <i>Elementet Gjeometrike te Projektimit ne Plan.....</i>                     | 27        |
| <b>9</b>  | <b>STUDIMI DHE PAKETA E SHTRESAVE RRUGORE .....</b>                          | <b>33</b> |
| 9.1       | <i>Objekti.....</i>  | 33        |
| 9.2       | <i>Metoda e zgjedhur per llogaritje .....</i>                                | 33        |
| 9.3       | <i>Baza e te dhenave me hipotezat .....</i>                                  | 33        |
| 9.4       | <i>Llogaritia e Paketes se Shtresave .....</i>                               | 35        |
| 9.5       | <i>Paketa e Propozuar .....</i>  | 36        |
| <b>10</b> | <b>SINJALISTIKA DHE SIGURIA RRUGORE .....</b>                                | <b>37</b> |
| 10.1      | <i>Sinjalistika .....</i>  | 37        |
|           | <i>Te per gjithshme .....</i>  | 37        |
|           | <i>Sinjalistika vertikale .....</i>  | 37        |
|           | <i>Vendosja .....</i>  | 37        |
|           | <i>Sinjalet e Ndalimit .....</i>   | 37        |

|   |           |
|---|-----------|
| <i>Sinjal e rrezikut.....</i>   | 38        |
| <i>Sinjal e perparese.....</i>  | 38        |
| <i>Sinjal detyruese.....</i>  | 38        |
| <i>Sinalizimi horizontal.....</i>   | 38        |
| 10.2 <i>Siguria rrugore .....</i>   | 38        |
| <i>Te pergjithshme .....</i>  | 38        |
| <b>11 PERSHKRIMI I PROJEKSTIT TE RRUGES .....</b>                                     | <b>40</b> |
| 11.1 <i>Standarti i ndjekur dhe seksioni terthor i Propozuar.....</i>                 | 40        |
| 11.2 <i>Seksioni terthor tip i miratuar.....</i>                                      | 40        |
| 11.3 <i>Shpejtuesia e Projektimit .....</i>   | 41        |
| 11.4 <i>Pervijimi horizontal .....</i>  | 42        |
| 11.5 <i>Parametrat gjeometrike te pervijimit vertikal .....</i>                       | 43        |
| 11.6 <i>Kanalizimet e ujerave te bardha .....</i>                                     | 44        |
| 11.7 <i>Kanalizimet e ujerave te ndotura .....</i>                                    | 45        |
| 11.8 <i>Muret Rrethues te Ndertesave.....</i>   | 45        |
| 11.9 <i>Ndricimi rrugor.....</i>  | 45        |
| 11.10 <i>Rrjeti internet – telefonise.....</i>  | 45        |
| <b>12 VLERESIMI I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL .....</b>                              | <b>46</b> |
| 12.1 <i>Kuadri ligjor per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.....</i>                    | 46        |
| 12.2 <i>Qellimi, objektivat dhe metodologja e ndejkur per hartimin e VNM-se .....</i> | 49        |
| <b>13 NDERHYRJET NE PLANIN E RRUGES.....</b>  | <b>51</b> |
| <b>14 VLERESIMI I KOSTOVE .....</b>   | <b>52</b> |
| 14.1 <i>Te pergjithshme mbi hartimin e nje preventivi .....</i>                       | 52        |
| 14.2 <i>Formati i preventivit .....</i>   | 53        |

**1 INFORMACION I PERGJITHSHEM MBI PROJEKTIN**

- **Titulli i Projektit:** Studim – Projektim “Ndërtimi rrugës ”Zef Serembe”
- **Vendi:** Tirane, Shqiperi
- **Klienti:** Bashkia Tirane
- **Konsulenti:** BOE “Seed Consulting sh.p.k & Atelier 4 sh.p.k”
- **Faza e Projektit:** Projekt Zbatimi
- **Data e dorezimit :** 29.12.2023

## 1.1 Informacion i per gjitshem



Shqiperia ndodhet ne Europen Juglindore dhe ka nje siperfaqe prej 28.748 km<sup>2</sup>. Kufizohet me Malin e Zi dhe Kosoven ne veri; Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise ne lindje; dhe Greqine ne jug. Shqiperia shtrihet ne bregdetin lindor te detit Adriatik, perballte krahines se Puglia-s se Italise.

Gjatesia e per gjithshme e kufirit te Shqiperise eshte 1.094 km. Kufijtë tokesore, detare, lilenore dhe lumore jane perkatesisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare eshte 427 km e gjate: 273 km i perkasin bregdetit te Adriatikut dhe 154 km bregdetit te Jonit.

Bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Popullsise ne vitin 2011, rezulton se popullsia e Shqiperise eshte 2,895,947 banore.

Terreni qe përshtuan Shqiperine eshte 70% terren malor dhe pjesa tjeter fushor, kodrinor e bregdetar. Rajonet bregdetare kane klimë te butë, por me ne brendesi dhe ne veri, klima karakterizohet nga dimer i ftohtë dhe vere me reshje te konsiderueshme.



Ne Shqiperi funksionojne disa modalitetë te transportit si :

- **Transporti ajror civil nderkombetar**
- **Transporti hekurudhor**
- **Transporti detar**

Rrjeti kombetar rrugor perbehet nga:

1. **Rrjeti Rrugor Paresor**, i cili eshte rreth 1.198 km i gjate dhe ka 9 arterie kryesore qe perbejnë rrjetin base;
2. **Rrjeti Dylesor**, i cili eshte rreth 2.083 km i gjate.

## 1.2 Qyteti I Tiranes

Tirana eshte kryeqendra e qarkut dhe rrthet me te njetin emer dhe kryeqyteti i Republikës se Shqiperise. Tirana ndodhet ne qender te Shqiperise, rreth 35 km ne lindje te Durrësit dhe rreth 40 km ne veri-perendim te Elbasanit, ne nje lugine te rrthuar nga Mali i Dajtit ne lindje, kodrat e Kerrabes dhe Saukut ne jug, kodrat e Vaqarrit dhe Yzberishtit ne perendim dhe ato te Kamzes ne veri.



Qyteti u themelua ne vitin 1614 nga Sulejman Pashe Bargjini, me origjine nga fshati Mullet dhe per here te pare emri i Tiranes permendet ne vitin 1418 ne nje dokument te Venedikut.

Gjate gjithe historise se saj ajo ishte nje qender romake (Theranda) dhe bizantine (periudhen e zgjerimit te saj te pare). Ajo u pushtua ne shekullin e pesembedhjete nga Perandoria turko-osmane, pushtim i cili ndikoi duke ndryshuar politiken, shoqerine, kulturen, arkitekturen dhe fene ne shekujt e mevonshem.

Tirana e shpalli pavarsine ne 26 nentor 1912 dhe u shpall kryeqytet i perkozhshem i Shqiperise ne 9 shkurt 1920 nga Kongresi i Lushnjes dhe pjesetaret e Keshillit Kombtar hyne ne qytet ne 11 shkurt 1920. Perfundimisht Tirana u shpall kryeqytet i Shqipersise ne vitin 1925 nga Asambleja Kushtetuese.

Ishte vendi qendror i Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise. Sot qyteti po perjeton nje periudhe te zhvillimit progresiv ekonomik, social dhe urban, me ndertimin dhe rregullimin monumental e parqeve, ndertesave, duke perfshire edhe rindertimin e objekteve fetare te shkattereduara gjate pushtimit turk dhe regjimit komunist.

Qyteti i Tiranes eshte qyteti me i madh i Shqiperise dhe qendra me e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit. Tirana ndodhet vetem 17 km larg aeroportit "Nene Tereza", i vetmi aeroport nderkombtar ne Shqiperi i njohur dhe me emrin Rinas. Ky aeroport eshte nyja me e rendesishme lidhese ndermjet Shqiperise dhe pjeses tjeter te botes. Tirana shtrihet ne koordinatat  $41.33^{\circ}$  veri dhe  $19.82^{\circ}$  lindje.

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartesia mesatare e fushes se Tiranes eshte 521 m, kurse dy malet me te larta rrez te cileve shtrihet jane Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m.

Qyteti gjendet rrreth 34 kilometra larg detit Adriatik ne perendim. Nga jugu dhe perendimi rrrethohet nga kodra relativisht te ulta, kurse nga ana veriperendimore Tirana shtrihet mbi nje zone te rrafshet.

## 2 OBJEKTIVAT E STUDIMIT

### 2.1 Qellimi i Pergjithshem

Objektivat e ketij studimi te vleresuara nga Konsulenti mbeten ne linje me ato te percaktuara ne detyren e projektimit si :

- Analizimi i gjendjes ekzistuese dhe nxjerja e nevojave per projektimin e infrastruktures
- Realizimi i projekt zbatimit per rikualifikimin e rruges duke perfshire raportin e ndikimit ne mjedis, shpronesimet e mundshme etj
- Projektimi gjeometrik, i shtresave rrugore, strukturave (nese ka) sistemimi i shesheve dhe parkimeve etj
- Permiresimi i cilesise, rrjedhshmerise dhe elementeve te sigurise ne lidhje me zgjidhjet e qarkullimit rrugor

### 2.2 Kuptimi i Detyres se Projektimit

Detyra e Projektimit percakton qarte objektivat, aktivitetet qe priten te ndermerren nga Konsulenti per arritjen e rezultateve te Projektit. Hartimi i projektit perfshin nje grup te perzgjedhur ekspertesh te ndryshem, per fusha te caktuara te inxhinierise qe kane lidhje me Projektin. Konsulenti ka perfshire ne staf specialiste me shume pervoje e te spikatur ne fushat e tyre, duke shfrytezuar njekohesisht te gjitha te dhenat dhe eksperienca e arritur ne vendin tone e me gjere.

Aspekte kryesore te identifikuara nga Konsulenti jane si me poshte :

Ekstrakt - DP

Ne Detyren e Projektimit eshte treguar qarte qellimi i punes, e cila konsiston ne hartimin e nje projekti zbatimi te detajuar per ndertimin e rruges “Zef Serembe”, me analizen dhe projektimin e te gjithe elementeve te infrastruktureve rrugore dhe urbane, sigurimin e levizjes ne rruge, ndikimin ne mjedis te nderhyrjeve si dhe vleresimin e shpronesimeve te mundshme.

Arsyetimi yne

Pas nje investigimi te situates ne terren, dhe ne bashkepunim te ngushte me Bashkine e Tiranes, do te tregohet kujdes i vecante persa i perket kritereve te eficences ekonomike te investimit dhe ceshtjeve mjedisore e sociale duke perfshire edhe ato te shpronesimit. Nje rendesi e vecante do t'i kushtohet edhe studimeve ekzistuese gjeologjike, hidrologjike dhe vizitave investigative ne terren per zonen e interesuar. Ne konsultim me Bashkine Tirane, ne do te propozojme dhe do te dakordesohemi per standartet e projektimit qe do te perdoren ne projekt.

Pas fizes se mesiperme te investigimit, do te pergatitet projekti sipas fazave te parashikuara ne kete Detyre Projektimi. Konsulenti do ti kushtoje vemendje dhe kujdes te vecante sinjalistikes vertikale rrugore dhe planit te vijezimeve, te cilat do te jene ne perputhje me standartet e kerkuara rrugore.

Nga Konsulenti do te trajtoher aksi rrugor i percaktuar nga Bashkia Tirane dhe niveli i nderhyrjes per ate aks do te percaktohet gjithashtu ne bashkepunim me Bashkine Tirane:

Me poshte jepen rezultatet kryesore qe duhet te arrihen nga Konsulenti per gjate fazes se pergatitjes se projektit:

- Te siguroje variantin me te mire te nderhyrjes, ne baze te gjendjes e analizes ekzistuese ne teresi dhe me argumentat perkatese.
- Te siguroje nje bashkepunim te ngushte dhe efektiv me Bashkine Tirane dhe institucionet te tjera te perfshira per aprosimin e Projektit te Zbatimit.
- Pergatitjen e Projektit te Zbatimit, Specifikimeve Teknike dhe Preventivit me perjegjesi dhe kujdesin e duhur.
- Kompletimi i sherbimeve te kerkuara sipas Grafikut te Punimeve.

Pasi Konsulenti ka studiuar Detyren e Projektimit, mund te shprehet si me poshte vijon:

- Bazuar ne Detyren e Projektimit dhe ne viziten ne terren, Konsulenti kupton qe kushtet ekzistuese dhe parametrat e infrastruktures rrugore jane te amortizuara. Eshte detyre e Konsulentit te pergatise Projektin e Zbatimit sipas Kushteve Standarte te Projektimit apo Standarteve te tjera te percaktuara nga Bashkia Tirane ne dokumentat e miratuara prej saj.
- Konsulenti do te analizoje me kujdes te gjitha dokumentat e vendosura ne dispozicion nga Bashkia Tirane, vecanerisht PDV e zones ku shtrihet objekti ne fjale dhe do ta zhvilloje projektin ne perputhshmeri me PDV e miratuara si dhe me konsultimin dhe miratimin e bashkise.
- Konsulenti do te pergatise projekt idene paraprake, ate perfundimtare dhe pas aprosimut te Klientit, do te zhvilloje Projektin e Zbatimit te detajuar duke i kushtuar kujdes te vecante zhvillimit te duhur te rrjeteteve inxhinierike, sitemimit urban, ceshtjeve te shpronesimeve dhe studimeve te tjera gjeologjike, hidrologjike apo investigimeve ne terren dhe sondazheve ne pika kyce.
- Do te realizoje sistemimin e kanalizimeve. Konsulenti do te mbledhe gjithe informacionin e nevojshem per studimet e meparshme, te tanishme (nese ka) dhe ne perspektive te kanalizimeve apo dhe te rrjeteteve te tjera inxhinierike qe mund te jene prezent ne kete zone (sistemin e largimit te ujerave dhe sistemin e furnzimit me uje te zones).
- Projekti i Zbatimit i detajuar do te shoqerohet me Preventivin perfundimtar, Raportin teknik perfundimtar (permbledhes), Raportet e vecanta teknike, Specifikimet teknike, Grafikun e punimeve, Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore perkatese (konform Termave te References), Raportin e Shpronesimeve.
- Eshte percaktuar me Autoritetin Kontraktor pika fundore e rruges dhe degezimi i saj.
- Eshte sqaruar perputhshmeria me PDV e njesive strukturore ku shtrihet zona objekt i ketij studimi.

### 3 IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

#### 3.1 Vizitat ne terren dhe grumbullimi i informacionit paraprak

Si nje nevojshmeri ne hartimin e projektit, grupi i projektimit ka kryer disa vizita ne terren ku dhe eshte njojur me gjendjen ekzistuese te ketij aksi rrugor.

Nga keto vizita eshte bere e mundur sigurimi i nje informacioni te nevojshem pamor si nje arkivim i nevojshem i cdo pjese te rruges ne hartimin e gjurmave per variatet qe jane propozuar por edhe per te pefituar informacionin e duhur ne lidhje me kushtet ekzistuese te shtresave rrugore.

#### 3.2 Foto te gjendjes ekzistuese

##### Pika e fillimit te projektit



##### Vazhdimi i gjurmes ekzistuese





Pika e lidhjes se aksit 1 me degezimin e aksit 1



Pika e lidhjes se aksit 1 me aksin 2



Figure 1 – Foto te rruges ekzistues

### 3.3 Pershkrimi i gjendjes ekzistuese

Ashtu si u permend dhe me siper aksi rrugor ne studim eshte rruga “Zef Serembe” e cila ndodhet ne Njesine Administrative Nr. 4 dhe nis nga kryqezimi me rrugen Myslym Keta dhe perfundon ne lidhjen me rrugen paralel me kompleksin Partizani. Gjithashtu pjesa e detyres se projektimit eshte dhe degezimi i rruges qe te con tek Sherbimi Gjeologjik Shqiptar.



*Figure 2 – Gjurma e projektit*

Fale vizitave ne terren kemi mundur qe te pervetesojme nje informacion te rendesishem rreth gjendjes ekzistuese te kesaj rruge, shtrirjes se saj, terrenit ne te cilin kalon si dhe rrjetet ekzistuese toksore dhe nentoksore (funkSIONALE dhe jo funsIONALE).

Aksi 1 eshte i gjate rreth 520 m (duke perfshire degezin qe akseson SHGJS). Aksi 1 eshte i shtruar me shtresa asfaltike me gjeresi rreth 4-5 m ne nje pjesa te saj perreth 200 m gjatesi. Pjesa tjeter e rruges eshte pa gjurmë ose gjurmë e hapur rishtazi me shtresa cakelli ose dhe natyror. Kjo rruge nuk ka trotuare. Ne gjatesi te rruges verehen disa shtylla elektrike ndersa rrjetet inxhinierike nentokesore gjenden vetem ne pjesa te caktuara te gjatesise se rruges.

Ne te gjithe gjatesine e rruges nuk ka kanalizime te ujerave te bardha (ujera atmosferik) te mirefillte si dhe nuk ka nje sistem te ndricimit rrugor.

Ne pamje te pare duket qarte qe ne kete rruge ka shume kohe qe nuk nderhyet si ne shtresa rrugore ashtu dhe ne rrjete inxhinierike apo mobilim urban. Shtresat rrugore jane teje te amortizuara dhe ne disa vende verehet dhe fenomeni i krijimit te gropave me thellesi deri ne disa centimetra.

Kjo situate behet akoma dhe me e pafavorshme (per levizjen e automjeteve) fal dhe pervijimit ekzistues vertikal qe kjo rruge ka me pjerresi deri ne 10%.

Ne te gjithe gjatesine e saj rruga ka dy pika me kthesa te forta, te cilat paraqiten dhe te rrezikshme per shkak te mungeses se pamshmerise. Ashtu si shtresat rrugore edhe ato pak metra linear trotuare qe ekzisojne jane tejet te amortizuar dhe te demtuar.

Ne DP permendet fakti qe ne kete rruge nuk ka rrjet ekzistues te ujerave te ndotura dhe as KUSH ndersa rrjeti i ujesjellsit eshte ekzistues dhe funksional ne pjesen me te madhe te rruges.

Pergjate aksit 1 ne krahun e majte te tij ne 300m e pare ka rrethime te pronave private me mure me blloqe betoni rreth 2m te larte ndersa ne krahun e djathte ne 250 m e pare ka ndertesa 2 kateshe te vendosura ne skaj te rruges, pjesa tjeter eshte terren natyral.

## 4 MBLEDHJA E KESHILLIT TEKNIK

### 4.1 Vendimi i Keshillit Teknik

Projekt ideja perfundimtare u paraqit ne Keshill Teknik ne daten 24/11/2023. Ne perfundim te diskutimeve u vendos nga ky keshill qe te mos kryhen ndryshime thelbesore nga projekt ideja perfundimtare dhe te vazhdohet puna me detajimin e projektin e zbatimit. Nje vendim tjeter i rendesishem ishte hartimi i preventivit te punimeve nepermjet platformes elektronike e-albania sipas standartit te sapo miratuar.




Figure 3 – Planimetria e rruges sipas projekt zbatimit

## 5 RILEVIMI TOPOGRAFIK

Eshet perqatitur nje raport i vecante per studimin topografik ku paraqet ne menyre te detajuar aktivitetet e realizuara.

### 5.1 Te pergjithshme

Punimet gjeodezike dhe topografike per projektimin e rruges “Zef Serembe” u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

I gjithe procesi topografik konsiston ne krijimin e nje harte dixhitale me nje gjeresi rreth nga 20 m per gjithe gjatesine e segmentit. E gjithe puna filloi me rikonjicionin e terrenit dhe ndertimin e stacioneve gjate gjithe gjatesise se rruges (te cilet do te perdoren dhe gjate ndertimit te vepres).

Punet topografike per ndertimin e kesaj harte konsistojne ne hapat e meposhtme:

- Ndertimi i Stacioneve & Matja e tyre me GPS
- Rilevimi i detajuar
- Perpunimi i te dheneve dhe hartimi i reliefit

## 6 STUDIMI GJEOLOGJIK

Eshet perqatitur nje raport i vecante qe pershkruan ne detaje studimin gjeologjik.

### 6.1 Ndertimi Gjeologjik - Harta Gjeologo-Inxhinierike

Qellimi i ketij studimi eshte njohja e ndertimit gjeologo-litologjik te zones se propozuar per ndertimin e ketij projekti , si :

- Vleresimi i veteve fiziko-mekanike te dherave , te ndara ne shtresa
- Vrojtimi i fenomeneve negative fiziko-gjeologjike, brenda territorit te sheshit te ndertimit dhe per rrreth tij
- Te dhena mbi ujrat nentokesore.

Per realizimin e ketij studimi jane marre parasysh te gjitha studimet gjeologo-inxhinerike te realizuar nga autoret e tjere te kesaj fushe per qellime ndertimi.

Krahas te dhenave te me siperme, eshte shfrytezuar harta gjeologjiko- inxhinierike e Shqiperise ne shkallen 1:25000, e cila eshte te mjaftueshme per te percaktuar kushtet gjeologo-inxhinerike te teritorit te ndertimit.

Per te perfituar te dhenat e nevojshme per hartimin e ketij studimi u bene shpime, me autosonde deri ne thellesi 10m nga toka natyrale si dhe u morren kampione ne thellesine deri ne 3m , perqjate zones, me qellim qe te percaktohet trashesia e perberjes se shtresave rrugore, ndertimin perberjen litologjike te bazamentit, treguesit fiziko-mekanik te shtresave duke perfshire CBR dhe Proctor.

Gjate shpimeve u moren kampione me strukture te prishur dhe te paprishur per tu analizuar, sipas standardeve perkatese per cdo prove (AASHTO , ASTM, UNI EN).

Mbeshtetur ne punimet e kryera eshte bere e mundur te realizohet nje vleresim mbi kushtet gjeologo-inxhinerike per fazen e projekt- zbatimit te zones ku shtrihet sheshi i ndertimit.

### 6.2 Ndertimi gjeologjik – harta gjeologo-inxhinierike

Tirana ben pjese ne zonen e Ultesires Perendimore te Shqiperise . Ne ndertimin gjeologjik te ultesires ne fjale brenda rajonit te studiuar nga depozitimet qe dalin ne siperfaqe ne ato te hapura me pus-shpime, marrin pjese kryesisht depozitimet e Eres Mesozoike dhe asaj Kenozoike duke filluar nga Sistemi i

Kretakut, Paleogenit deri ne ato te Kuaternarit, te cilat sipas perberjes litologjike mund te klasifikohen ne kater grupe:

- Formacioni karbonatik
- Formacioni flishor dhe flishoidal
- Formacioni mollasik
- Formacioni kuaternar
- 

Depozitimet e Paleogenit, Neogenit dhe Kuaternarit ndryshojne trashesine e tyre nga krahu lindor ne ate veriperendimor.

### **FORMACIONI KARBONATIK**

#### **Kretaku (Cr)**

Depozitimet karbonatike te Kretakut jane depozitimet me te vjetra qe zbulohen ne siperfaqe ne zonen e studuar. Keto depozitime takohen ne strukturen karbonatike te Makareshit e cila ben pjesa ne zonen Tektonike Kruja. Ato karakterizohen nga ndryshime te theksuara faciale si dhe perfaqesohen nga gelqeroret e Kretakut te siper Cr2 (gelqerore me rudiste dhe gelqerore te dolomitizuar) dhe gelqeroret e Eocenit Pg2 (gelqerore biomikritike dhe turbiditike) qe vendosen ne kontakt direkt me depozitimet e Miocenit te mesem N12.

#### **Kretaku i siper Cr2**

Keto depozitime takohen ne strukturen karbonatike te zbuluar ne siperfaqe, ne Makaresh.

Ne strukturen e Makareshit, pjesa e poshtme e prerjes perfaqesohet nga dolomite me nderthurje gelqeroresh dolomitike qe permajne ne disa shtresa dhe rudiste. Me siper prerja predominohet nga gelqerore dolomitike, me nderthurje me te rralla dolomitesh masive. Ne prerjen me te siperme takohen dolomite me nderthurje gelqeroresh biokllastike shtrese-trashe.

#### **Oligocen i poshtem (Pg31)**

Ne zonen tone depozitimet e Oligocenit te poshtem shtrihen ne krahan lindor te Makareshit dhe te antiklinalit te Dajtit. Ky seksion perfaqesohet nga fushi argiloalevrolito-ranor me horizonte vithisese dhe olistolite gelqeroresh (Harta Gjeologjike e Shqiperise, 2002). Ne kete zone pjesa e poshtme perfaqesohet nga pakuja mergelore kalimtare, me perberje litologjike pothuajse te njejte. Mbi pakon mergelore kalimtare, vijon suksesivisht fushi i holle argilo-ranor. Nga studimet tematike eshte verejtur se trashesia e ketij fushi rritet nga perendimi ne lindje, madje dhe brenda te njejtes strukture. Keshtu ne krahan perendimor te antiklinalit te Dajtit ajo eshte 250 m (prerja e Krujes), ndersa ne krahan lindor ajo i kalon 1000m. Ne vazhdim mbi fushin ranoro-argjilore me vithisje nenujore vendosen ranore masive, fushi argilo-ranor

#### **Tortoniani (N13 t)**

Formacionet e Tortonianit ndertojne pothuajse te gjithe sinklinalin e Tiranes. Ne zonen e studimit depozitimet e tortonianit (N13t) shtrihen ne pjesen perendimore te tij (Harta Gjeologjike e Shqiperise). Depozitimet e Tortonianit si ne siperfaqe dhe ne thellesi perfaquesohen nga dy litofacie: Litofacia ranoro-argjilore, e cila ka perhapje ne pjesen periferike te Ultesires Adriatike dhe te zones se Adriatikut Jugor, sidomos mbi orogenjen e prane tij, si dhe litofacia argjiloranore qe takohet ne pjesen perendimore te Ultesires Adriatike dhe gjithe qendren e basenit. Kjo litofacie karakterizohet nga ranore e argjila te nderthurur dhe me gelqerore litotamnike te cilet jane depozitime te nje ambienti te ceket, kryesishet shelfore. Ranoret paraqiten me ngjyre gri te celur deri te zverdhur, ndersa ne thyerje te fresket kane ngjyre bezhe te erret. Jane kompakte, kokerrmedhenj, deri kokermesem. Trashesite e shtresave luhaten nga 0.5-1.5 m deri 5-6 m. Gelqeroret lithotamnike paraqiten ne trajten e shtresave me perhapje jo shume te madhe dhe me trashesi 2-3 m deri 7-8 m, ndonjehere permabajne shume litotamnie dhe makrofaune te llojeve te ndryshme. Keto te fundit takohen ne pjesen e siperme te tyre, kur litologjikisht kalojne ne argjila alevrolitore. Ndersa litofacia tjeter argjilo-ranore karakterizohet nga depozitime te nje ambienti te thelle. Karakteristike e litofacies se dyte eshte se trupat ranore jane te tipit linzor, me perhapje te kufizuar dhe te formave gjenetike me teper kanalore. Ne pjesen veriperendimore te depresionit, depozitimet e Tortonianit vendosen suksesivisht mbi ato te Seravalianit. Dallojme kater formacione te Tortonianit:

**Formacioni Priska (N13t)** – fillon me nje horizont konglomeratesh ose brekçesh bazale. Pjesa e poshtme e prerjes perfaquesohet nga ranore shtrese trashe, masive, me ndershtresa alevrolitesh ose ranoresh gravelitike te kuquerremte. Ne pjesen e mesme te prerjes shtohen ndershtresat alevrolite mes ranoreve, ndersa ne pjesen e siperme shfaqen gelqeroret rifore, kryesishet litotamnike, te cilet drejt veriut pykezohen. Ne sektorin qendor – jugor, mbi ranoret gravelitike te kuquerremte vijojne nderthurje argjilo – alevrolitiko – ranorike me qymyre e stome ostreash. Ne malin e Dajtit drejt Priskes mbi boksite kemi konglobrekçe, gelqerore, etj.

**Formacioni Skuterra (N13t)** – perfaquesohet nga nderthurje paketash te trasha argjiloro – alevrolitike, ngjyre hiri te kalter, me ndershtresa te rralla ranoresh polimikte kokrrize imet-mesem deri gravelitike ne pjesen e poshtme. Mes argjilave takohen ndershtresa te rralla qymyresh te murme dhe rreshpesh qymyrore – argjilore dhe stome organogjene (kryesishet me ostrea).

**Formacioni Iba (N13t)** – ranore shtrese trashe deri masive me shtresezim te gershetuar. Rralle ndershtresa e thjerza gravelitike. Ngjyra e ranoreve verdhacake e çelet, paksa e kuquerremte. Kemi te bejme kryesishet me ranore polimikte kuarc – felshpatike, kokrrize trashe- mesem me cimentim te dobet (“shtufore”). Ne ranoret rralle ndeshen dhe copa druri te gurezuar. Shume rralle ne pjesen e siperme takohen dhe ndershtresa argjilore, alevrolitike e mergelesh si dhe qymyre te murrme e rreshpe qymyrore.

**Formacioni Mezezi (N13t)** – perfaquesohet nga ranore te ngjashem me te Ibes ne pjesen e poshtme te pjeses veriore te rajonit qe ne pjesen jugore dhe qendrore kalojne facialisht ne alevrolite e argjila me ndershtresa te rralla ranorike. Me siper prera e formacionit Mezezi eshte me nderthurje te argjilave ngjyre hiri – kaltershe me alevrolito – argjiloro – ranore dhe ndershtresa te rralla ranoresh e alevrolitesh. Ne prera ndeshen ndershtresa qymyresh te murme dhe rreshpe qymyrore – argjilore.

## 7 STUDIMI HIDROLOGJIK

Eshëtë percatitur një raport i vecante që përkruan ne detaje studimin hidrologjik.

### 7.1 Klima


Për përshkrimin e elementeve të përgjithshme klimatike si reshjet, temperatura e ajrit, lagështia etj, janë përdorur të dhënat e stacionit meteorologjik të Kamzës i cili ndodhet vetëm 5 kilometra larg qendrës së Tiranës.

### 7.2 Zona klimatike

Zona në studim ndodhet brenda zonës klimatike mesdhetare fushore. Kështu, reshjet vjetore luhaten ndërmjet 950-1200 mm. Reshjet e borës janë një fenomen i rrallë dhe një shtresë e qëndrueshme bore pothuajse nuk vërehet kurrë.

Temperaturat minimale absolute luhaten nga -3 deri në -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vërehen vlera më të ulëta të temperaturave minimale. Periudha me ngrrica është e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrrica mund të arrijë 12-15 në vit, gjatë së cilës vlerat e temperaturave minimale ulen nën 0°C.

Era në përgjithësi fryshtësohet nga dy drejtime. Gjatë stinës së ftohtë mbizotëron era nga juglindja dhe veriu, ndërsa gjatë stinës së ngrohtë dominon era nga drejtimi veriperëndimor. Shpejtësia maksimale të erës në këtë zonë gjatë stinës së ngrohtë tregojnë vlera 10-15 m/s, ndërsa në sezonin e ftohtë afersisht 25-30 m/s.



*Figura 4 – Zonimi klimatik i Shqipërisë*

### 7.3 Temperatura

Temperatura e ajrit është një element i rëndësishëm klimatik, i cili shpreh madhësinë e energjisë diellore në afersi të Tokës. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen temperaturat mesatare mujore të matura në Stacionin e Kamëzit. Nga këto të dhëna shihet se vlera mesatare maksimale është arritur në korrik ( $23.4^{\circ}\text{C}$ ), ndërsa vlera minimale në janar ( $6.5^{\circ}\text{C}$ ). Vlera mesatare për të gjithë vitin është  $14.9^{\circ}\text{C}$ .

| Muaj                     | 1   | 2   | 3   | 4    | 5    | 6    | 7    | 8    | 9    | 10   | 11   | 12  | viti |
|--------------------------|-----|-----|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|-----|------|
| Temp. $^{\circ}\text{C}$ | 6.5 | 7.8 | 9.9 | 13.1 | 17.6 | 21.4 | 23.4 | 23.3 | 20.3 | 15.9 | 11.8 | 7.9 | 14.9 |

*Tabela 1 - Temperaturat mesatare mujore të ajrit*




Figura 5 – Temperaturat mesatare mujore të ajrit

#### 7.4 Mjegullat

Në projektimin e rrugës është e rëndësishme të dihet numri i ditëve me mjegull dhe kohëzgjatja e tyre. Numri i ditëve me mjegull ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga një vend në tjetrin. Analiza e numrit të ditëve me mjegull tregon se nuk ka rregull në shpërndarjen e mjegullave në muajt e ndryshëm të vitit. Megjithatë, në zonat kodrinore, numri i ditëve me mjegull është më i madh në fillim të vjeshtës, në dimër dhe në fillim të pranverës. Në zonën në studim numri mesatar i ditëve me mjegull është 7 - 8 ditë/vit, me maksimum në muajt shtator dhe mars.

| Muaj            | 1   | 2   | 3   | 4   | 5   | 6   | 7   | 8   | 9   | 10  | 11  | 12  | vite |
|-----------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| Ditë me mjegull | 0.1 | 0.2 | 1.0 | 0.4 | 0.8 | 0.5 | 0.5 | 1.2 | 1.6 | 0.5 | 0.1 | 0.3 | 7.4  |

Tabela 2 - Numri i ditëve me mjegull

#### 7.5 Reshjet

Reshjet janë një element i rëndësishëm për projektimin e rrugëve, veçanërisht të dhënat për intensitetet e reshjeve. Vlerat mujore të reshjeve për një vit mesatar jepen në tabelën e mëposhtme, të ndjekura nga paraqitja grafike përkatëse e shpërndarjes së tyre ndërvjetore.

Nga këto të dhëna shihet se vlerat mesatare maksimale vërehen në muajt e dimrit dhe ato minimale në muajin korrik. Vlera mesatare për të gjithë vitin është 1299 mm. Numri i ditëve me shtresë reshjesh më shumë se 0.1 mm luhatet nga 85 deri në 100 ditë. Në përgjithësi, reshjet maksimale nuk janë të rrëmbyeshme.

Reshjet e borës janë një fenomen i rrallë dhe në këtë zonë nuk vërehet një shtresë e rëndësishme dhe e qëndrueshme bore. Shtresa maksimale e borës në përgjithësi arrin vlerën 5 - 10 cm dhe shumë rrallë 15-17 cm

| Muaj    | 1   | 2     | 3     | 4     | 5    | 6    | 7    | 8    | 9    | 10    | 11    | 12    | viti |
|---------|-----|-------|-------|-------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|------|
| Reshjet | 151 | 121.5 | 126.5 | 110.4 | 92.9 | 65.2 | 46.2 | 57.9 | 80.8 | 110.6 | 138.1 | 158.7 | 1299 |

Tabela 3 - Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve (mm)




Figura 6 – Shpërndarja ndërvjetore e reshjeve (mm)

Mesatarisht në këtë zonë vihet re një rritje e reshjeve vjetore prej rreth 110 mm për çdo 100 m lartësi. Numri i ditëve me  $\geq$  Reshjet 1,0 mm variojnë nga 1,6 ditë (korrik) deri në 9,1 ditë (nëntor). Gjatë vitit ka mesatarisht 76.9 ditë me reshje  $\geq 1.0$  mm.

## 7.6 Sistemi i kullimit

Sistemi I kullimit te rrugeve ne studim duket te jete I amortizuar . Shumica e rrugeve kane kuneta te demtuara plotesisht ose pjeserisht , si dhe puseta drenazhimi. Ne fazat e mevoshme pas analizimit dhe realizimit te studimit hidrologjik , do te percaktohet nese rrjeti ekzistues eshte funksional dhe mund te perdoret apo do te duhet te ribehet nga fillimi per shkak te mosfunkcionimit, dimensioneve te papershtatshme , difekteve te ndryshme ne gjatesi apo si nevoje e zvendesimit te plete te paketes se shtresave .

## 7.7 Sistemi i furnizimit me ujë

Ujësjellësi i Tiranës është shumë i vështirë për t'u përshkruar. Nuk ka një strukturë të rregullt për të përshkruar llojin e shpërndarjes së rrjetit (qyqe, rrethore etj). Sistemi i furnizimit me ujë duket i zhvilluar shumë rastësisht pasi qyteti është zgjeruar nga viti 1990 deri në ditët e sotme. Do te merren informacione nga institucionet perkatese ne lidhje me shtrirjen e ketij rrjeti ne zone.

## 7.8 Të dhënat hidrologjike

Hetimi i reshjeve të mëdha është thelbësor për të përcaktuar intensitetin klimatik dhe probabilitetin e ngjarjeve të stuhisë. Është thelbësore të përftohet shkarkimi maksimal me probabilitet të caktuar tejkalimi. Kjo është e nevojshme për të përfunduar dizajnin e:

- Kanalet
- Sistemi i kullimit për platformën e rrugës.
- Sistemi i kullimit ne sheshe

Basenet brenda rajonit të studimit variojnë nga një shkallë shumë e vogël në të mesme të vogël (dmth., kohëzgjatja tipike kritike është në një shkallë nën-ditore). Kështu, reshjet e shkurtra dhe shumë të shkurtra (dhe shumë intensive) trajtohen në këtë kapitull.

Klima e Shqipërisë në përgjithësi është mesdhetare me një farë klime kontinentale në rajonet malore në pjesën veriore, qendrore dhe jugore të vendit. Vendi kombinon një fushë bregdetare në Perëndim me male mjaft të larta: pika më e lartë arrin 2751 m në kufirin e trefishtë me Jugosllavinë dhe Maqedoninë, ndërsa shumë kreshta tejkalojnë 2000 m në pjesët veriore, qendrore dhe jugore të vendit. Reshjet e shiut vijnë kryesisht me erëra jugperëndimore dhe bien sipas pengesave të hasura. Kjo jep një shumëllojshmëri të klimave dhe modeleve të reshjeve në rajone të ndryshme të vendit. Siç tregojnë vlerat e nxjerra për stacionet me 30 vjet vëzhgim të vazhdueshëm:

Reshjet mesatare vjetore janë rreth 1485 mm; Modeli sezonal është shumë konsistent, me korrikun, ndonjëherë gushtin, si muajin më të thatë dhe nëntorin, ndonjëherë dhjetorin, si muajin më të lagësht.

## 7.9 Reshjet maksimale

Mesatarja e reshjeve (si në shkallën vjetore ashtu edhe për çdo sezon) janë raportuar në tabelën e mëposhtme; të dhënat ekstreme të regjistruara jepen në kolonën e fundit.


Reshjet mesatare vjetore variojnë nga 700 mm në Shqipërinë juglindore në 3500 mm në veri, me një vlerë mesatare në mbarë vendin prej 1485 mm (Bogdani dhe Selenica, 1997). Reshjet maksimale ditore në Alpe janë 300-400 mm dhe në rajonin malor jugor 200-300 mm.

Në përgjithësi përmbytjet kanë një origjinë pluviale, por ndonjëherë ato përfaqësohen nga një përzierje balte, uji dhe bora e shkrirë.

| Station                                | Above sea level | Mean annual rainfall | Totals |       |        |       | Daily maximum |
|--|-----------------|----------------------|--------|-------|--------|-------|---------------|
|  |                 |                      | XII-II | III-V | VI-III | IX-XI |               |
|  | m               | mm                   | mm     | mm    | mm     | mm    | mm/24 hours   |
| <b>Mediterranean-atlantic zone:</b>    |                 |                      |        |       |        |       |               |
| Durres                                 | 9               | 1040,9               | 377,7  | 207,9 | 82,0   | 373,3 | 104,0         |
| Vlora                                  | 13              | 1047,6               | 432,7  | 183,9 | 61,3   | 369,7 | 82,2          |
| Himara                                 | 3               | 1555,3               | 705,3  | 272,0 | 51,2   | 526,8 | 350,0         |
| <b>Mediterranean-continental zone:</b> |                 |                      |        |       |        |       |               |
| Puka                                   | 864             | 2054,0               | 679,7  | 424,1 | 231,3  | 718,9 | 156,3         |
| Peshkopi                               | 625             | 946,0                | 302,6  | 214,8 | 125,8  | 302,8 | 70,0          |
| Voskopoje                              | 1248            | 900,5                | 296,3  | 199,5 | 105,8  | 298,9 | 66,0          |
| <b>Transitive zone:</b>                |                 |                      |        |       |        |       |               |
| Shkodra                                | 26              | 1707,4               | 573,7  | 340,3 | 127,2  | 666,2 | 195,4         |
| Tirana                                 | 121             | 1189,5               | 382,4  | 282,6 | 129,6  | 394,9 | 237,4         |
| Permet                                 | 190             | 1259,0               | 513,6  | 229,3 | 94,4   | 421,7 | 117,0         |

*Tabela 4 - Reshjet mesatare dhe sezonale vjetore dhe maksimalet ditore për stacione të ndryshme meteorologjike*

Reshjet vjetore shtrihen në intervalin midis 1000 dhe 2000 mm në vit, me vlera më të mëdha në zonat malore të ekspozuara ndaj rrymave të rrjedhës perëndimore dhe jugperëndimore. Vlerat tregojnë se – përvèç ndryshueshmërisë hapësinore – reshjet mesatare vjetore janë zakonisht të larta. Një hartë e shpërndarjes hapësinore të lartësisë së reshjeve 24 orëshe me një probabilitet 1% është dhënë në figurën e mëposhtme më poshtë.



*Figura 7 – Shpërndarja hapësinore e reshjeve maksimale ditore në të gjithë Shqipërinë*

### 7.10 Formulat baze ne llogaritjet hidraulike te sistemit te kullimit

Per sasite e ujравe te shiut do te perdoren te dhenat e Institutit Hidrometeorologjik dhe menyra e llogaritjes do te paraqitet nga projektuesi ne menyre te argumentuar ne fazat ne vijim.

Siguria llogaritese e ujравe te shiut do te llogaritet 25 % per kolektoret kryesore dhe 40 % per kolektoret sekondare.

Vlera e llogaritjes se shiut te merret per periudhe perseritje 1 here ne vit dhe kohezgjatje prej 15 minutash. Intensiteti per Tiranen eshte 150-170 litra/sek/ha e cila del me llogaritje.

Llogaritjet hidraulike te sistemit te kullimit ndahen ne dy faza:

1. Llogaritjet hidrologjike te prurjeve te rrjedhjeve siperfaquesore te krijuara nga reshjet atmosferike mbi siperfaqen e rruges.
2. Llogaritjet hidraulike te permasimit te elementeve perberes te sistemit te siperpermendor.

## Llogaritjet hidrologjike

Llogaritjet hidrologjike te percaktimit te prurjeve te ujit te krijuara nga reshjet mbi siperfaqet e rruges jane llogaritur, sipas metodes racionale, me formulen e meposhtme:

$$Q = k \times C \times i \times A \quad [m^3/\text{sek}]$$

ku:

$K = 0.00278$ , koeficient i sistemit metrik te llogaritjes

$C$  - koeficient i rrjedhjes siperfaquesore te URA, me vlera

$$C = 0.95 - \text{per siperfaqen e rruges}$$

$C = 0.7 - \text{per siperfaqen shkembore te shpatit mbi rrugen kryesore (pjerresia e madhe)}$  dhe  
 $C = 0.55 - 0.70, \text{ per siperfaqen shkembore midis rruges kryesore dhe rruges se sherbimit}$

$i$  – intensiteti i reshjeve atmosferike, per periudhe perseritjeje  $T = 50$  vjet, nga buletini meteorologjik i shirave maksimale, IHM, Tirane, 1985

$i = 180 \text{ mm/ore}$ , intensiteti i shiut per rruget, me kohezgjatjeje  $t = 10 \text{ min}$ ,

$i = 165 \text{ mm/ore}$ , intensiteti i shiut per siperfaqet shkembore, me kohezgjatjeje  $t = 20 \text{ min}$ ,

$A$  = siperfaqja kontribuese e rrjedhjeve siperfaquesore (rruga ose shpati).

## Llogaritjet hidraulike

Bazuar ne prurjet e krijuara nga reshjet ne rrjedhjet siperfaquesore jane llogaritur kapacitetet dhe nivelet maksimale te ujerave ne kunetat anesore te rruges. Gjithashtu, bazuar ne keto llogaritje, dhe ne funksion te kapacitetit shimbledhes te tyre, jane percaktuar edhe distancat e pusetave dhe te piletave. Koeficentet e bllokimit te zgarave jane pranuar  $K = 0.50$  (pra 50 % e siperfaqes qe fut ujin, konsiderohet e mbuluar nga mbeturinat).

Formula e perdorur per llogaritjen e kunetave, te kanaleve te hapura dhe te tubacioneve eshte formula Chezy – Manning, si me poshte:

$$Q = S \times C \times \sqrt{(R \times i)} \quad [m^3/\text{sek}]$$

Ku:

$Q$  = prurja e percjelle nga kuneta

$C = 1/n \ R^{(1/6)}$ , koeficienti Chezy per kanalin

$R$  = rrezja hidraulike e rrjedhjes

$i$  = pjerresia gjatesore e rruges.

## 8 PROJEKTIMI I RRUGES

### 8.1 Standartet Rrugore te Projektimit

Konsulenti zhvilloi projektimin e ketij rrjeti rrugor sipas standardeve gjeometrike me te fundit dhe me te pershtatshme.

- Rregullat Teknike te Projektimit te Rrugeve, VKM nr.628, date 15.07.2015 "Per Miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve"
- Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkise Tirane 14.07.2017
- AASHTO (SHBA)

Megjithese Rregullat Teknike te Projektimit te Rrugeve te listuara me siper perbejne bazen e vetme ligjore te aprovuar ku nje projektues shqiptar (apo dhe i huaj qe projekton nje aks rrugor brenda kufirit te Shqiperise) mund te marre te gjitha te dhenat dhe parametrat gjeometrike per te nisur projektimin e nje rrule ato (ne faqen 1108 te tyre) i perjashtojne ato urbane (d.m.th. rruget qe jane nen pronesine e bashkive). Kjo lidhet me faktin se cdo bashki harton nje Plan te Pergjithshem Vendor, pjese te te cilit ka dhe sektorin perkates te percaktimit te Rrjetit Rrugor dhe strukturat e Rrjetit Rrugor si dhe permasat.

Nderkohe nga Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkise Tirane mund te merren vetem te dhena persa i perkthet seksioneve terthore (gjeresine e korsive dhe numrin e tyre, gjeresine e trotuareve etj...) dhe shpejtesine limit per secilen kategori rruge.

Pershkrimet e meposhtme te parametrave projektues do te mbeshteten kryesisht ne: Rregullat Teknike te Projektimit te Rrugeve, VKM nr.628, date 15.07.2015 "Per Miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve"

### 8.2 Klasifikimi rrugor

Nisur nga sa me siper, standarti i projektimit te rruges, i perdorur nga Konsulenti si reference per te gjitha çeshtjet qe lidhen me parametrat gjeometrike dhe percaktimin e gjurmave te propozuara te rruges se re, "Zef Serembe" do te permbushe cilesite me te larta persa i perkthet:

- Sigurise;
- Kapacitetit;
- Sjelljes se Perdoruesve te Rruges;
- Shpejtesise se pranuar te Projektimit.



Persa i perkthet funksionit kryesor qe do te kryeje kjo rruge ne te ardhmen, ajo i perkthet Kategorise Rrule lokale "F".

**RRUGË E KATEGORISË F**

Zgjdhja bazë 1+1-kors  
TDMV  
<1000 mjete/24 orë

**RRUGË RURALE LOKALE**

$V_{Dmin}=25 \text{ km/h}$   
 $V_{Dmax}=60 \text{ km/h}$



Kategorite e kaluesve qe do te lejohet te perdonin rrugen e re jane:

- Autovetura;
- Autobuse;
- Motocikleta;
- Mjete jo motorike;
- Njerez
- Kafshe

### 8.3 Elementet Gjeometrike te Projektimit ne Plan

#### Shpejtesia e Projektimit

Megjithese shpejtesia e projektimit vendos graden maksimale te kurbatureve dhe distancen maksimale te shikuesherise per operim te sigurt, nuk duhet te kete kufizime ne perdonimin e lakoreve horizontale te sheshta ose distancave me te medha te shikimit, ku permiresime te tilla mund te sigurohen si pjese e projektimit ekonomik.

Megjithate, nese kthesat e sheshta ose seksione tangente do te inkruajonin shoferet te operonin ne shpejtesi me te medha, atehere projektimi i kthesave do te marre ne konsiderate shpejtesine maksimale te propozuar.

### Gjurma Horizontale

Gjurma horizontale duhet te siguroje per operim te sigurte dhe te vazhdueshem ne nje shpejtesi projektimi uniforme per gjatesite substanciale te rruges . Standartet duhet te aplikohen ne cdo kthesa , pervecse kur paraqitet e pamundur dhe ne keto raste specifikohen arsyet dhe zgjidhja me e mire e mundshme . Keto standarte aplikohen gjithashtu edhe ne kryqezime dhe pjesa te rrugeve lokale.

Karakteristikat me kryesore ne projektimin e gjurmës horizontale jane siguria, profili, tipi i facilitetit, shpejtesia e projektuar, karakteristikat gjeoteknikë, topografia, kostot e ndertimit dhe shpronësimit. Ne projektim, siguria konsiderohet gjithmone , qofte direkt ose indirekt. Shpejtesia e projektuar, ne kthese, kontrollon distancen e shikimit, por distanca e shikimit duhet marre ne konsiderate bashke me topografine sepse shpesh ajo kerkon nje reze me te madhe se shpejtesia e projektuar. Te gjithe keta faktore duhet te balancohen per te perfthuar nje gjurme qe optimizon permbushjen e objektivave te ndryshem si siguria, kostot, harmonia me konturin natyror te tokes, dhe ne te njejten kohe te pershtatshme per klasifikimin e projektit te rruges.Gjurma horizontale duhet te siguroje te pakten minimumin e distances se shikuesherise per ndalim per shpejtesine e zgjedhur te projektit ne te gjitha pikat e rruges.

### Vijat e drejta

Sekcionet e gjata te drejta me pjerresi konstante mund te kene disa disavantazhe. Vecanerisht ato mundet:

- Te motivojne shoferin te ngase me shpejt
- Te rrisin rrezikshmerine e verbimit nga ana e kundert e mjeteve gjate nates
- Te shkaktojne lodhje ne pjesen me te madhe te perdoruesve te rruges

Formula e meposhtme perdoret per te llogaritur gjatesine minimale te segmentit te drejte lidhur me shpejtesine e projektuar  $L_r=22*VD[m]$

| VD<br>(km/hr) | 40 | 50 | 60 | 70 | 80 | 90  | 100 | 110 | 120 | 130 | 140 |
|---------------|----|----|----|----|----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| Lmin (m)      | 30 | 40 | 50 | 65 | 90 | 115 | 150 | 190 | 250 | 300 | 360 |

**Tabele 5 –Gjatesia minimale e vijes se drejte**


### Kthesat Rrethore

Per lakimet rrethore rrezet duhet te perzgjidhen aq te medha sa te jete e mundur sipas topografise, ne menyre qe te arrihet: distance shikimi per parakalim te mjaftueshem; ruajtjen e njetrajtshmerise gjate drejtimit. Per kete projekt duhet te marrim ne konsiderate gjeometrine ekzistuese, keshtu qe lakoret e reja rrethore jane shume te kondicionuara nga lakoret rrethore ekzistuese.

Ndermjet dy kthesave rrethore ne te njejtin ose ne krah te kundert, rreza e ketyre kthesave duhet te jete rezultat i nje raporti te balancuar me sigurine e trafikut. Kur projektohen autostradat (A) dhe rruget rurale paresore (B), sekuenaca e rrezeve duhet te jete brenda zones se mire.

Ndermjet nje segmenti te drejte me gjatesi Lr dhe lakoresh rrethore me treze minimale duhet te respektohet rapporti i meposhtem:

$$R > LR \text{ per } LR < 300\text{m} \quad R \geq 400\text{m} \text{ per } LR \geq 300\text{m}$$



**Figure 8** – Distanca e nevojshme per ndalim

Rrezja minimale R ne varesi te shpejtesise se projektimit dhe te sektionit terhor paraqitet ne tabelen e meposhtme::

| VD (km/h)  | min R (m) | min L (m) |
|------------|-----------|-----------|
| <b>50</b>  | 80        | 30        |
| <b>60</b>  | 120       | 35        |
| <b>70</b>  | 180       | 40        |
| <b>80</b>  | 250       | 45        |
| <b>90</b>  | 340       | 50        |
| <b>100</b> | 450       | 55        |
| <b>120</b> | 720       | 65        |

**Tabele 6** –Rrezja minimale dhe gjatesia minimale e nje kthese rrethore

Per shpejtesi projektimi me pak se 50 km/h, ne mungese te standardeve shqiptare, eshte marre ne konsiderate Standarti Italian i Projektimit.

### Kthesat Horizontale (me gjatesi spirale)

Per te siguruar nje kalim gradual nga segmenti vijedrejte ne ate rrethor te planimetrise, duke siguruar keshtu nje ndryshim uniform te shpejtesise si dhe nje ndryshim te nxitimit centrifugal i cili perputhet me

dinamiken e levizjes se mjetit, perdonimi i nje distance per tranzisionin e nje pjerresie gjatesore te lejuar per linjen e ekstremiteve te platformes, ben te mundur rezultimin ne nje planimetri optikisht te sakte. Perdonimi i lakoreve me rreze te ndryshueshme kerkohet per te gjitha kategorite e rrugeve. Per rakordimin horizontal te pjeseve vijedrejta dhe te harqeve rrethore te aksit te rruges, perdoret klotoida e cila eshte ajo lakore qe ndryshon lakoreturen nga via e drejte ne hark rrethor. Teorikisht klotoida perkufizohet si me poshte:

$$r * s_n = A_{n+1}$$

| VD (km/h) | min A (m) |
|-----------|-----------|
| 40        | 80        |
| 50        | 120       |
| 80        | 180       |
| 100       | 250       |
| 120       | 340       |
| 140       | 450       |

**Tabele 7** – Vlerat minimale te parametrit A per “Gjatesine Spirale”

Ne llogaritje e bera parametrit te klotoideve eshte marre ne konsiderate ekuacioni i meposhtem:

**Kushti dinamik  $A \geq 0.17 \times \sqrt{V_3}$**

Ku  $V$  - eshte shpejtesia e projektit

**Kushti optik  $R/3 \leq A \leq R$**

Ku  $R$  eshte rrezja e harkut rrethor

**Kushti i pjerresive  $A \geq \sqrt{R \times B \times i / 2k}$**

Ku  $R$  - eshte rrezja e harkut rrethor ne [m];

$B$  - eshte gjeresia e shtreses rrugore ne [m];

$i$  - eshte pjerresia perpendikulare e shtreses rrugore;

$k$ - eshte pjerresia gjatesore e vijes se jashtme drejtuese;  $A$  – parametri i klothoides [m].

Ky ekuacion ne te gjitha rrezet ku jane aplikuar klotoidat plotesohet dhe eshte konform normes se projektimit.

Perjashtim ben kthesa e pare e cila duke konsideruar se kendi i kthese ka nje ndryshim kendor prej  $10^\circ$  nuk jane realizuar klotoidat dhe si rregull i plotesuar ne norme ehte aplikuar gjatesia e lakores rrethor eshte sa dyfishi i shpejtesise se projektimit.

Parametri  $A$  i klotoideve te perdonura ne projekt eshte specifikuar te lakoret rrethore ne tabelen e mesiperme me vlerat perkatese dhe i ploteson te gjitha kerkesat e normes se projektimit.

### Distanca e shikimit

Per te ofruar nje siguri trafiku dhe nivel sherbimi te duhur, kerkohen distanca minimale shikimi. Distanca e shikimit eshte gjatesia ne vazhdim e rruges perpara e shikueshme nga drejtuesi i automjetit..

**Distanca e shikimit e kerkuar per ndalim**

Distanca e shikimit e kerkuar per ndalim eshte ajo distance qe nje drejtues i cili udheton me shpejtesine e projektimit i nevojitet per te ndaluar automjetin e tij perpara se te godase nje pengese te papritur. Ajo perbehet nga distanca qe pershkoni nje automjet gjate kohes se reagimit te drejtuesit dhe distances per vetefrenim.

**Gjurma Vertikale**

Gjurma vertikale eshte nje vije orientimi me ane te se ciles percaktohet trashesia e shtresave dhe e elementeve te tjere te rruges. Ajo diktohet kryesisht prej topografise, llojit te rruges, planimetrise, dhe performances se automjeteve te renda, kostove per shpronesim, sigurise, distances se shikimit, kostove te ndertimit, zhvillimit kulturor, drenazhimit, dhe pamjes se kendshme. Megjithate, gjurma e re vertikale e propozuar paraqet permiresime ne seksione te ndryshme krahasuar me ate ekzistuese.

Pjerresite gjatesore maksimale te dhena ne Tabele nuk duhet te tejkalojen, per arsyte te sigurise se trafikut.

| Klasifikimi I Rrugeve            | Pjerresia gjatesore maksimale i(%) |
|----------------------------------|------------------------------------|
| Autostrade “A”                   | 5                                  |
| Rruge Interurbane Kryesore “B”   | 6                                  |
| Rruge Interurbane Sekondare “C”  | 7                                  |
| Rruge lokale nderurbane / Rurale | 10                                 |

**Tabele 8 – Pjerresia gjatesore maksimale**

Tabela e mesiperme e mare nga Rregullat teknike te Projektimit jep vlera vetem per kategori rruges te ndryshme nga kategoria e rruges ne studim, megjithate kategoria e fundit i afrohet me shume rruges ne fjale ndaj Klienti gjate hartimit te gjurmës vertikale ( Pervijimit Vertikal ) ka mare si vlera orientuese pjerresie maksimale 10%.

Sigurisht ne fazat ne vijim me zgjedhjen e gjurmës perfundimtare do te mund te behen dhe permiresimet e duhura te gjurmës vertikal

Lakoret vertikale duhet te projektohen ne menyren e duhur, per te ofruar distancen e nevojshme te shikimit, siguri, komoditet ne drejtimin e automjetit, drenim te mire, dhe pamje te kendshme. Ne profilin gjatesor te rruges zakonisht si mjet rakordimi perdoren lakoret parabolike por eshte krejtesisht e pranueshme qe te perdoren edhe harjet e thjeshta rrethor me rreze >1500m.

Gjatesia e lakores vertikale llogaritet duke perdorur ekuacionin e meposhtem

$$L = Rv \frac{\Delta i}{100}$$

$\Delta i$ - variacioni i pjerresive

Rv – Reze vertikale

| VD<br>(km/h) | min RVS (m)<br>lakore konkave | min RV (m)<br>lakore konvekse |
|--------------|-------------------------------|-------------------------------|
| <b>50</b>    | 500                           | 1400                          |
| <b>60</b>    | 750                           | 2400                          |
| <b>70</b>    | 1000                          | 3150                          |
| <b>80</b>    | 1300                          | 4400                          |
| <b>90</b>    | 2400                          | 5700                          |
| <b>100</b>   | 3800                          | 8300                          |
| <b>120</b>   | 8800                          | 16000                         |

**Tabele 9** - Rezet minimale te lakoreve vertikale

Per shpejtesi me te vogel se 50 km/h, ne mungese te te dhenave ne Standartin Shqiptar te Projektimit, jane marre ne konsiderate vlerat e prezantuar ne Standartin Italian te Projektimit.

Per diferencat algjebrike te pjerresive gjatesore prej 2% dhe me te medha, dhe per shpejtesi te projektimit te barabarta ose me te medha se 60 km/h, gjatesia minimale e lakores vertikale ne metra duhet te jete e barabarte me  $2V$ , ku  $V$  = shpejtesia projektuese.

Per diferencat algjebrike te pjerresive me me pak se 2% ose shpejtesi projektimi me te vogla se 60 km/h, gjatesia e lakores vertikale duhet te jete minimalisht 60 m.

## 9 STUDIMI DHE PAKETA E SHTRESAVE RRUGORE

### 9.1 Objekti

Ky eshte nje raport qe permban nje studimin per paketen e shtresave qe do te perdoren per rrugen Zef Serembe

Qellimi i ketij relacioni eshte llogaritja e paketes se shtresave rrugore (dyshemese) ne perputhje me metodat llogaritese te njoitura e te percaktuara ne standartet e miratuara te projektimit te rrugeve. Keto llogaritje do te sherbejne per te percaktuar dimensionimin, kuantifikimin dhe specifikimet teknike per shtresat rrugore te projektit

Projektimi i shtresave rrugore do te jete procesi i zhvillimit te kombinimit me ekonomik te shtresave te dyshemese rrugore, ne funksion te trashesise dhe llojit te materialit, per te mbrojtur themelin e dheut nga ngarkesa akumuluese te qarkullimit qe pritet te mbahet gjate periudhes per te cilen projektohet Objektivat e proçesit te projektimit te dyshemeve duhet te ofroje:

- Shtresa te cilat jane te afta te mbartin ngarkesa trafiku me konsumim fizik sa me te vogel
- Siguri sa me te larte

### 9.2 Metoda e zgjedhur per llogaritje

Per arritjen ne nje rezultat te pranueshem e sa me efektiv si nga pikepamja teknike ashtu edhe nga ajo ekonomike konsulenti duke u bazuar dhe ne rekondimet te dhena ne TeR , eshte mbeshtetur ne hipotezat dhe parametrat llogarites te disa prej metodave llogaritese me te njoitura bashkekohore per paketat rrugore fleksibel si:

- Procedura e projektimit AASHTO 1986;
- Udhëzues i Projektimit te Shtresave CNR.

si dhe manuale e studime bashkekohore te autoreve te ndryshem te prezantuara ne forumet inxhinierike nderkombetare si p.sh "MDSHA Evaluation of Mechanistic-Empirical Design Procedure-Volume 2, CBR-Index soil properties Samar A.Taha - Academia.edu\_files", etj.

Te gjitha keto metoda llogaritese konkludojn ne pothuajse te njejtat rezultate pak a shume konstruktive per funksionin dhe ngarkesen qe do te kete rruga jone. Gjithsesi, ne perputhje me traditen dhe praktiken e llogaritjeve te modelit te shtresave fleksibel ne vendin tone te reflektuar edhe ne standardin e miratuar te projektimit te rrugeve, kemi zgjedhur modelimin e paketes rrugore ne baze te llogaritjeve sipas metodes AASHTO '93.

### 9.3 Baza e te dhenave me hipotezat

Procesi fillestar i projektimit AASHTO kishte plotesisht një karakter empirik; rishikimet e mevonshme kane perfshire disa masa mekanike si, klasifikimi i shtangesise se tabanit ne terma te modulit te elasticitetit dhe marrja ne konsiderate e ndryshimeve sezionale ne shtangesine e materialit. Procesi i projektimit AASHTO zhvilloi konceptin e demtimit te shtreses bazuar ne perkeqesimin e cilesise se udhetueshmerise siç perceptohet nga perdoruesi. Keshtuqe, mbarevajta eshte e lidhur me demtimin e cilesise se udhetueshmerise ne kohe, ose ushtrimi i ngarkeses se trafikut. AASHTO zhvilloi konceptin e ngarkeses se pergjithshme te trafikut ne terma te një ngarkese statike te vetme e njojur si ngarkese njeaksiale ekuivalente 80-kN (ESAL).

Ne baze te llogaritjeve per dimensionimin korrekt te shtresave rrugore te paketes se rruges sone, qendrojne te dhenat baze te ngarkeses aksiale ekuivalente ESAL te derivuar nga trafiku perspektiv per një jetegjatesi 30 vjeçare te paketes si dhe te dhenat e kapacitetit dhe tipologjise se tabanit ku zhvillohet rruga ( CBR/Mr ).

Persa i perket te dhenave te trafikut te gjeneruar ne kete rruge, konsulenti eshte bazuar ne informacionet e tij per matjet e trafikut te segmentet nationale perreth saj, ne vrojtimet e shkembimeve te gjithanshme sipas modelit Origjine-Destinacion ne zonen e perfshire nga projekti, si dhe ne perspektiven afatgjate te zhvillimit te zones dhe te vendit ne teresi.

Persa i perket te dhenave te tjera llogaritese dhe hipotezave te modelit AASHTO per tipologjine e shtresave me te pershtatshme si dhe te kategorise se rruges sone ato me se shumti bazohen ne percaktimin e Modulit te reaksionit te tabanit Mr dhe Numrit Strukturor te shtresave Sn. Eksperiencia shumevjeçare amerikane e provuar edhe ne modelet reale demonstron se relacioni me i besueshem per llogaritjen e shtresave eshte ai logaritmik i perfthuar nga formula llogaritese e meposhtme:

$$\log_{10}(W_{18}) = Z_R \times S_o + 9.36 \times \log_{10}(SN+1) - 0.20 + \frac{\log_{10}\left(\frac{\Delta PSI}{4.2-1.5}\right)}{0.40 + \frac{1094}{(SN+1)^{5.19}}} + 2.32 \times \log_{10}(M_R) - 8.07$$

ku:  $E_{18}$  = Numri i parashikuar i ngarkeses ekuivalente aksiale 80 kN (ESAL)

$Z_R$  = Devijimi matematikor normal

$S_o$  = Gabimi standard i kombinuar i te dhenave te trafikut dhe i performances se shtresave

$SN$  = Numri Strukturor (një indeks indikativ i trashesise totale te nevojshme te shtresave )

=  $a_1D_1 + a_2D_2m_2 + a_3D_3m_3 + \dots$  ku  $a_i$  = keof. i shtreses se  $i$ ;  $D_i$  = trashesia e shtreses  $i$  (inches);  $m_i$  = koef.i drenimit te shtreses  $i$

DPSI = Diferenca mes indeksit te nivelit te sherbimit fillestar te projektit po dhe atij ne fund te sherbimit pt

MR = Moduli reaktiv mbetes (psi)

Ky model llogarites logaritmik me 2 variabla interaktive si ESAL dhe Sn ekzekutohet ne menyre te perseritur per te verifikuar rezultatet nese njera prej variablave fiksohet paraprakisht ne baze te hipotezave ndihmese te metodes. Per te mundesuar nje llogaritje te shpejte AASHTO ka vene ne dispozicion te perdoruesve nje program kompjuterik i cili ndihmon ne ekzekutimin e disa llogaritjeve te ndryshme sipas hipotezave te ndryshme ne funksion te trafikut, te kapacitetit mbajtes te tabanit, te kushteve te sherbimit te rruges, kategorikes se saj etj.

#### 9.4 Llogaritja e Paketes se Shtresave

Pas grumbullimit te te gjithe informacionit te nevojshem behet nje seleksionim i kujdeshme i tij per te arritur ne marrjen e dy parametrave baze mbi te cilen mbeshtetet metodika llogaritese e zgjedhur:

- CBR-ja e mar nga testimet ne terren
- MVT-DJA( Mesatarja vjetore e trafikut ditor ose AADT sipas gjuhes angleze) e llogaritur nga nje studim paraprak i trafikut te kesaj rruge.

Gjithashtu ne hartimin paketes se re te shtresave do te merret parasysh dhe rekomandimi i studimit gjeologjik : qe te behet rindertim teresor i trupit (paketes se shtresave) te rruges.

---

#### Nxjerra e te dhenave te duhura per perllogaritjen e Modulit Reaktiv MR nepermjet vlerave te CBR-se.

Elementi i domosdoshem per dimensionimin e shtresave eshte kapaciteti mbajtes i tabanit te rruges i cili perfaqesohet nga moduli Mr dhe perftohet nga korrelacionet standarde empirike te metodes AASHTO , Mr-CBR. Kapaciteti mbajtes i nenshtresave te tabanit i perfaqesuar nga CBR eshte percaktuar ne Studimin gjeologjik nepermjet sondazheve te kampioneve te marra ne terrene te trajtuar me pas ne laborator.

Keshtu per çdo shtrese gjeologjike te hasur kemi korrelacionin:Mr (psi) = 1,500 x CBR(%)

---

#### Nxjerra e te dhenave te duhura per perllogaritjen e MVT

Pas grumbullimit te te dhenave te tafikut procedohet me perllogaritjen e Njesise Ekuivalente Standarte.

Fillimisht llogaritet numri i akseve ekuivalente standarde 80 kN qe do te percaktojne ngarkesen dinamike qe do te kete rruga ne periudhen 20 vjeçare te sherbimit efektiv te saj. Per kete Konsulenti ka shfrytezuar nje model kompjuterik llogarites te standardizuar per Metoden AASHTO. Ky model eshte i bazuar ne nje

sere parametresh qe sherbejne si Input-e per programin dhe qe parashikojne te dhena si: (i)jetegjatesia e rruges, (ii) AADT fillestare, (iii) perqindja e trafikut te rende, (iv) rritja e trafikut ne perqindje etj.

m (faktor i drenimit) = 1.

## 9.5 Paketa e Propozuar

Duke qene se rruga eshte e patrajtuar , pjeserisht e mbuluar me asfalt , paketa e zgjedhur do te jete pakete e plote si me poshte :



**Figure 9 – Paketa e shtresave rrugore**

Paketa e shtresave qe do te perdoret per trotuaret do te jete si me poshte :



**Figure 10 – Paketa e shtresave ne trotuare**

**10 SINJALISTIKA DHE SIGURIA RRUGORE**

Zhvillimet bashkekohore ne rrjetin rrugor urban dhe interurban si dhe fenomenet e dukshme me pasoja aksidentet qe jane konstatuar, e bejne te domosdoshem realizimin e nje projekti per aplikimin konkret te sinjalizimit rrugor ne tere gamen e tij. Hartimi i projektit te sinjalizimit rrugor, eshte mbeshtetur ne legislacionin ne fuqi :

- Ligjin Nr. 8378, date 22.07.1998, “Kodi Rrugar i Republikës se Shqipërisë”
- Vendimin Nr. 153, date 07.04.2000 te Keshillit te Ministrave, “Rregullore per Zbatimin e Kodit Rrugar”
- Vendimin Nr. 628, date 15.07.2015 te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e rregullave teknike te projektimit dhe ndertimit te rrugeve"

**10.1 Sinjalistika****Te pergjithshme**

Ruga perbehet nga nje karrekhate me dy korsi me sense te kunderta levizje. Gjurma e rruges me nje gjatesi prej rreth 500 kalon ne nje zone te banuar me disa kthesa te njepasnjeshme ne fillim te saj. Shpejtesia e levizjes do te jete 30 km/h pasi duhet siguruar nje levizje qe ti pershtatet aspektit urban dhe njekohesisht terrenit te cilin përkon gjurma e rruges.

**Sinjalistika vertikale**

Sinjalizimi vertikal, me tabela si ato te rrezikut, urdheruese ose treguese duhet te kete ne pjesen e perparme te dallueshme nga perdoruesit e rruges, formen, permasat, ngjyren dhe karakteristikat, ne perputhje me normat e rregullores se zbatimit te Kodit Rrugar dhe sipas figurave e tabelave qe Jane pjesa plotesuese e saj.

**Vendosja**

Parashikohet te vendosen tabela sinjalizuese. Duke ndjekur rregullin e percaktuar nga kodi rrugor sinjalet vertikale jane vendosur ne anen e djathte te rruges. Gjithashtu rekomandojme qe mbajteset e sinjaleve duhet te fiksohen ne distance jo me te vogel se 50 cm nga buza e trotuarit ose nga ana e jashtme e bankines.

**Sinjalet e Ndalimit**

Sinjalet e ndalimit ju ndalojne perdoruesve te rruges qarkullimin ose drejtime te veçanta te levizjes, nje manover te veçante, ose vendosin kufizime. Jane vendosur tabela te shpejtesise se levizjes qe do te

ndihmojne nje ngadalesim shpejtesie, rritje vigjilence dhe nje manovrim me te dimensionuar gjate fazes se hyrjes apo daljes nga rruga si dhe tabela ndalim qendrimi, te cilat ndalojne qendrimin ne gjithe gjatesine e rruges.

### Sinjalet e rrezikut

Sinjalet e rrezikut paralajmerojne pranine e rreziqeve, tregojne natyren e tyre dhe i detyrojne drejtueseve te e mjeteve te mbajne nje qendrim te kujdeshem. Keto sinjale jane vendosur per gjurmese se Bypass-it. Jane vendosur tabela rreziku qe do te ndihmojne ne evidentimin e rreziqeve dhe marrjen e masave per shhangjen e tyre.

### Sinjalet e perparesise

Parashikohet te vendosen tabela te tipit : ndalim dhe dhenie perparesie , te cilat tregojne detyrimin per te ndaluar dhe dhenien e perparesise perpara se te futesh ne kryqezim,ne menyre qe levizja e trafikut te kryhet e sigurte.

### Sinjalet detyruese

Sinjalet detyruese bejne te ditur detyrimet te cilat duhet tu nenshtrohen perdoruesit e rruges. Jane vendosur tabela detyruese qe do te ndihmojne gjate fazes se hyrjes apo daljes nga rruga e re urbane.

### Sinjalizimi horizontal

Sinjalet horizontale, te shenuara ne rruge, sherbejne per te rregulluar qarkullimin, per te drejtuar perdoruesit dhe per te dhene udhezime dhe tregues te dobishem per sjellje te vecanta per t'u mbajtur. E gjithe rruga do te shtrohet me shtresa asfaltike dhe do te vijezohet me vija anesore dhe qendrore te bardha. Aty ku do te kerkohet do te vendosen dhe vijat e bardha per kalimin e kembesoreve.

Per kete sinjalistike me udhezim nga TeR do te perdoret boje bikomponente dhe tip paste.

## 10.2 Siguria rrugore

### Te per gjithshme

Ne menyre qe te gjithe manovrat e parashikuara, gjate pershkimit te segmentit te projektuar, nga automjetet dhe kembesoret te kryhen ne kushte sigurie, eshte parashikuar qe per gjate trotuarit, ne anen e jashtme te tij , ne rastet kur kemi pranine e mureve mbajtes te vendosen mbrojtese metalike sigurie . Gjithashtu rruga gjate oreve te nates do te jete e ndriçuar, ndriçim i cili sigurohet nga rrjeti i ndriçimit rrugor te vendosur ne trotuar.

Per te garantuar nje siguri me te larte per banoret e zones ne gjatesi te rruges eshte menduar te vendosen 6 kurrise artificial ( ne zonat ku ka me shume banesa afer apo ne zonat ku ka gjatesi te medha vijedrejta ) te cilet do te ndihmojne dhe udhezojne drejtuesin e mjeteve te uli shpejtesine ne minimum kur kalon mbi to. Kjo praktik do te eliminoj dhe nje fenomen shume shqetesues qe ndodh rëndom pas asfaltimit te rrugeve neper zona rrurale dhe qe eshte vendosja nga ana e banoreve te objekteve te ndryshem te ulet ( terhorazi me rruge) per te penguar drejtuesit e mjeteve te ngrejne shpejtesine .Do te jene fazat e metejshme qe do te percaktojne numrin e sakte te vendosjes se tyre dhe pozicionin.


## 11 PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE RRUGES

### 11.1 Standarti i ndjekur dhe seksioni terthor i Propozuar

Variantet qe u propozuan ne mbledhjet e kaluara te Keshillit Teknik nga Konsulenti mbeshtetet ne rekomandimet qe Bashkia e Tiranes ka propozuar per te ndjekur gjate hartimit te projektit. Mbeshtetur ne Planin e Pergjithshem Vendor te Bashkise Tirane si dhe ne Manualin per Projektimit te Rrugeve kemi dy zgjidhje per rruget lokale sic tregohet ne shembujt e meposhtem.


#### **RRUGË E KATEGORISË F**

Zgjidhja bazë 1+1-kors  
TDMV  
<1000 mjetë/24 orë



#### **RRUGË RURALE LOKALE**


$V_{Dmin}=25$  km/h  
 $V_{Dmax}=60$  km/h



**Figura 11 – Seksioni terthor tip i Rruges Lokale te kategorise F**

### 11.2 Seksioni terthor tip i miratuar

Seksioni terthor tip i rruges i miratuar do te jetë si me poshte:



**Figura 12 – Seksioni terthor tip**

**Sekcioni terthor i rruges** ka nje gjeresi totale 9 m dhe pjesa asfatike (vija e kalimit te mjeteve) e rruges eshte 5.5 m (2.75 m per korsi kalimi), per kete arsye dhe pjerresia terthore e saj eshte menduar te jete ne nje ane me vleren 2.5%.

Trotuari eshte i vendosur ne te dy anet e rruges ne te gjithe gjatesine e saj duke qene se ka akses kembesoresh ne te dy anet dhe ka nje gjeresi totale 3m (dy trotuare nga 1.5 m), me pjerresi 1% ne drejtim te kullimit te ujrage, me bordura fillimi 20x35cm dhe me bordura fundore 15x30cm.

Kemi zgjedhur qe te vendosim trotuar ne te gjithe gjatesine e rruges pasi nderprerja e tij ne zonat qe nuk kane ndertesa (te cilat jane shume te kufizuara) do te sillte nje rrezikshmeri te madhe per komunitetin pas rikonstruksionit te rruges. Gjithashtu mosnderprerja e trotuarit lidhet dhe me aspektin shume te rendesishem qe duhet te merret gjithmone ne konsiderate gjate hartimit te nje rruge te re dhe qe eshte zhvillimi i metejshem i zones dhe rritja e popullsise se saj. Ne te gjitha hyrje daljet e objekteve do te kemi zbatimin e uljes se trotuarit per te mundesuar aksesin.

### 11.3 Shpejtesia e Projektimit

Meqenese rruga ne studim do te projektohet me parametrat e nje rruge urbane si dhe duke pasur parasysh ambientin ne te cilin ajo zhvillohet (pervijimin horizontal dhe vertikal) si dhe duke u mbeshtetur ne rregulloren e Kodit Rrugor, Klienti propozon qe shpejtesia e projektimit te kesaj rruge te jete 20 km/h e diktuar kjo nga kthesave te forta ne forme serpentine ne progresivat 0+200 deri ne 0+290 si dhe ne teresi nga pervijimi vertikal me vlera te konsiderueshme.

Aplikimi i nje shpejtesie projektimi me te madhe, mendojme se do te shtonte rrezikun per aksidente.

Kjo shpejtesi projektimi vlen per te tre akset e paraqitura ne projekt zbatim, pasi rruga do te konceptohet dhe do te projektohet si nje aks rrugor me karakter urban si dhe te tre akset kane pak a shume te njejtin pervijim horizontal dhe vertikal.

#### 11.4 Pervijimi horizontal

Rruga perbehet nga nje aks kryesor - aksi 1 dhe dy akse degezime qe mundesojne aksesin ne zone.

Gjurma e aksit 1 eshte e gjate 430m dhe ka nje gjeresi terthore totale 9m. Rruga do te jete me dy sense kalimi dhe do te jete e gjitha e shtruar me shtresa siperfaqesore asfaltike (shih kapitullin e shtresave rrugore).

Gjurma ka ne total 8 kurba horizontale me rreze qe variojne nga 12 m deri ne 300m. Vlera 12m perdoret ne kthesen me numer 4 per nga radha dhe ka vleren me te vogel pasi ne kete pike gjurma ekzistuese eshte e pafovorschme per te aplikuar rreze me vlere te madhe. Keto kurba jane brenda paramerave e standarteve per keto kategori rruges, duke ju referuar dhe shpejtesise se projektimit.

Ne Standartin Shqiptar te Projektimit te Rrugeve eshte e shkruajtur qarte se kurbat kalimtare duhet te perdoren ne cdo kategori rruge (perjashtuar rastet kur rrezja e ktheses eshte me e madhe se 1000 m ), por gjithashtu ky standart i perjashton rruget me karakter urban nga perdorimi i disa parametrave dhe kushteve qe ai vet permban dhe pershkruan. Kjo lidhet ngushtesisht me faktorin qe kemi permendur me siper dhe qe eshte shpejtesia e projektimit. Duke qene nje shpejtesi projektimi e ulet aplikimi i kurbave kalimtare behet i panevojshem.

Gjurma e degezimit te aksit 1 eshte e gjate 90m dhe ka nje gjeresi terthore totale 9m. Rruga do te jete me dy sense kalimi dhe do te jete e gjitha e shtruar me te njejtat shtresa si aksi 1.


Gjurma e aksit 2 i cili mundeson nje lidhje alternative eshte e gjate rreth 90m dhe ka te njejtin seksion terhor tip si aksi 1.

Pergjate gjithe rruges jane bere te gjitha rakordimet e duhura me rruget e tjera ekzistuese deri ne nje shtrirje rreth 10 m, per te mundesuar nje pershatje te nevojshme te gjurmese se re me ato ekzisuese.

Ne pjeset kur kemi hyrje neper banesa jane parashikuar rakordimet e nevojshme te trotuareve. Keto rakordime jane rampa me dy pjerresi anesore dhe nje qendrore dhe qe ne filim te tyre lidhen me kuneten nepermjet kthimit te bordures fillestare per se gjeri.

Te gjithe elementet e pershkruar me siper jane te paraqitur ne menyre te detajuar ne vizatimet e planimetrisë si dhe ne fletet e detajeve te trotuareve.

Me poshte po paraqesim planimetrine e gjurmese se rruges.

**Figura 13 – Planimetria e rrugeve**


### 11.5 Parametrat gjeometrike te pervijimit vertikal

Gjate hartimit te profilit gjatesor Klienti eshte munduar qe te qendroje sa me afer kuotes se rruges ekzistuese, kjo jo vetem per faktin se rruga ne te gjithe gjatesine e saj ka hyrje neper banesa, por edhe per te minimizuar ne maksimum mbushjet dhe germimet rrugore. Pjerresia maksimale gjatesore ne aksin 1 eshte 8.5%. Kjo pjerresi gjatesore i perkthet vetem rakordimit me rrugen kryesore. Ne pjeset e tjera pjerresia gjatesore eshte nen 7%. Pjerresia minimale gjatesore eshte 1.2%, duke siguruar ne kete menyre dhe pjerresine minimale gjatesore per largimin e ujerave nga platforma rrugore.

Kuota e projektit ne strukturat ekzistuese propozohet ne te njejtin nivel me ate te tokes ekzistuese. Ne disa pika jane bere disa korrigjime per te mundesuar realizimin e nje gjurme te re vertikale sipas kodeve te reja te projektimit.

Degezimi i aksit 1 gjithashtu ka nje pjerresi maksimale prej 12%. Reduktimi i kesaj pjerresie nuk eshte i mundur pasi krijon diferenca te medha me aksesin e objektit te Drejtorese se Pergjithshme te Burgjeve.

Me poshte po paraqesim nje pamje nga profili vertikal i rruges.

**Figura 14 – Pjese nga Profili gjatesor**

## 11.6 Kanalizimet e ujerave te bardha

Sistemi i kullimit te rruges do te sherbeje per kapjen dhe largimin e ujerave te reshjeve atmosferike nga siperfaqja e rruges. Ky sistem eshte konceptuar ne menyre te tille qe ti pershtatet edhe struktura se rruges. Per shkak te seksionit terthor me nje pjerresi dhe sistemi i ri i kanalizimeve te ujerave te bardha (atmosferike) do te ndodhet vetem ne krahun e majte te rruges .

Per kete arsy, sistemi do te ndertohet me puseta shimbledhese, te cilat do te percjellin ujerat e reshjeve atmosferike ne linjat e tubacioneve HDPE (polietilen me dendesi te larte) te brinjezuar per rezistence mekanike me te mire (te klases se rezistencies SN8). Ne projekt, keto linja tubacionesh do te emertoohen “Tub HDPE i brinjezuar SN 8 Dj 315 mm”.

Tubacionet parashikohen te vendosen ne thellesi minimale  $h = 0.6 \div 0.7 + Dj$  [m]. Tubacionet do te vendosen nen kuneten e rruges (shih projektin), paralel me aksin e rruges, ne nje ane te rruges, perveç kthesave ku tubacionet do te vendosen ne pjesen e brendshme te ktheses.

## 11.7 Kanalizimet e ujerve te ndotura

Sipas informacioneve te marra nga UKT dhe drejtorete perkatese te Bashkise Tirane rrjeti i kanalizimeve te ujerve te zeza shtrihet ne anen e djathje te rruges, shume prane me kufijte e objekteve ekzistues. Per shkak te ndertimit te trotuareve pozicioni i ketij rrjeti kanalizimi duhet spostuar ne qender te aksit te rruges. Ne teresi jane ruajtur te njejtat karakteristika hidraulike si dhe jane vendosur puseta kontrolli sipas standartit te projektit.

## 11.8 Muret Rrethues te Ndertesave

Per shkak te zgjerimi te rruges, pothuajse te gjithe muret rrethues te ndertesave ne anen e majte te rruges duhet te prishen. Konsulenti ka parashikuar rindertimin e tyre sipas nje detaji tip te perdonur nga Bashkia Tirane ne projekte te ngjashme. Per qellime vleresimi te kostove konsulenti i ka perfshire keto zera ne preventivin e punimeve.

## 11.9 Ndricimi rrugor

Ne kete rruge nuk ekziston ndriçimi rrugor. Konsulenti ka projektuar ndricimin per gjate gjithe gjatesise se rruges ne zonat e banuara dhe nga njera ane e rruges, ne krahun e majte te rruges. Lartesia dhe shpeshtesa e shtyllave do te parashikohet sipas standarteve ne fuqi. Projektuesi i eshte referuar Masterplanit te ndricimit te qytetit te Tiranes si dhe normave Europiane te performances se ndriçimit EN 13201.

## 11.10 Rrjeti internet – telefonise

Nuk eshte identifikuar nje rrjet ekzistues i rrjetit te telefonise dhe internetit. Per kete konsulenti ka projektuar ndertimin e linjave te reja te rrjetit nentokesore, te vendosura ne trotuarin ne anen e majte te rruges.

## 12.1 Kuadri ligjor per Vleresimin e Ndikritit ne Mjedis

Kuadri ligjor per Mbrojtjen e Mjedisit ne Republiken e Shqiperise eshte ne perputhje me standartet e BE- se.

Ky projekt do te implementohet ne Bashkine e Tiranes.

Ne baze te ligjit Ne mbeshtetje te ligjit nr. 10440 “Per Vleresimin e Ndikritit ne Mjedis” “ ;neni 8, ky project kerkon “Vleresim Paraprak Te Ndikritit ne Mjedis ” ,sipas shtojces 2; pika 10;“Projektet e infrastruktureve”, germa(b) “ Projektet e Zhvillimit Urban , duke perfshire ndertimin e qendrave tregtare dhe parkinget e makinave ,Ndertim rrugesh, portesh dhe instalimesh per porte “(Projekte qe nuk perfshihen ne shtojcen I)

Ky ligj ka per qellim te siguroje :

- Nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara qe perpara miratimit te tyre per zhvillim ;
- Garantim i nje procesi te hapur vendimmarjeje, gjate identifikimit, pershkrimit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur, si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Objktivi i ketij ligji eshte te percaktoje kerkesat, pergjegjesite, rregullat dhe procedurat per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative ne mjedisin e Republikes se Shqiperise dhe projektet e propozuara private apo publike.

Legjislacioni Shqiptar percakton strukturen e permbytjes se raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis qe te jete sa me konciz ne informacion qe duhet te perfshiye sipas VKM Nr. 912, date 11.11.2015 “ Per Miratimin E Metodologjise Kombetare Te Procesit Te Vleresimit Te Ndikritit Ne Mjedis ”.

Ligji Nr. 10431 date 10.03.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”. Ky ligj ka per qellim mbrojtjen e mjedisit ne nje nivel te larte, ruajtjen dhe permiresimin e tij, parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj jetes e shendetit te njeriut, sigurimin dhe permiresimin e cilesise se jetes, ne dobi te brezave te sotem dhe te ardhshem, si dhe sigurimin e kushteve per zhvillimin e qendrueshem te vendit.

Ne baze te ketij ligji, nen 3 i tij, citojme objektivat e mbrojtjes se mjedisit:

- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te çdo lloji;
- ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i natyres dhe i biodiversitetit;
- ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i qendrueshmerise mjedisore me pjesemarrje publike;
- perdonimi i matur dhe racional i natyres dhe i burimeve te saj;

- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike te peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe permiresimi i kushteve te mjedisit

Parimet e mbeshtetura ne Kreun II te ligjit nr. 10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”.

- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i kujdesit
- Parimi i parandalimit
- Parimi "ndotesi paguan"
- Parimi i riparimit te demeve mjedisore, perteritjes e riaftesimit te mjedisit te demtuar
- Parimi i pergjegjesise ligjore
- Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte
- Parimi i integrimit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale
- Parimi i ndergjegjesimit dhe i pjesemarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore
- Parimi i transparences ne vendimmarrjen mjedisore

Permbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional

Legjislacioni mjedor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket permendim:

*Tabela 1: Permbledhje e kuadrit ligjor mjedor*

| Legal Framework   |  |
|---|--|
| Ligji Nr.10 431 date 9.6.2011   | Per mbrojtjen e Mjedisit   |
| Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011  | Per vleresimin e ndikimit ne mjedis  |
| Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011  | Per lejet e mjedisit   |
| Ligji Nr.9362, date 24.03.2005  | Per sherbimin e mbrojtjes se bimeve  |
| Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011   | Per menaxhimin e integruar te mbetjeve   |
| Ligji Nr.8897, date 16.05.2002  | Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja   |
| Ligji Nr.9587, date 20.07.2006  | Per mbrojtjen e biodiversitetit  |
| Ligji Nr.8906, date 6.6.2002  | Per zonat e mbrojtura I ndryshuar me:<br>- Ligjin Nr.9868, date 04.02.2008   |
| Ligji Nr. 9774, date 12.07.2007   | Per administrimin e zhurmës ne mjedis  |
| Ligji Nr. 107/2014, date 31.7.2014  | “Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me<br>Ligjin Nr. 73/2015, date 09.7.2015 "Per disa shtesa dhe<br>ndryshime ne Ligjin Nr. 107/2014 “Per Planifikimin dhe<br>Zhvillimin e Territorit” |
| Ne Parlamentin e Republikës se Shqiperise jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit<br>tone ne Protokolle dhe Marreveshje te ndryshme. Nder to permendim |  |

|   |  |
|---|--|
| Ligji Nr. 9672, date 26.10.2000           | Per ratifikimin e konvetes se Aarhusit “Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimmarrje, si dhe per t’iu drejtuar gjykates per çeshtjet e mjedisit”.                          |
| Ligji Nr. 9334, date 16.12.2004           | Per aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFC).  |
| Ligji Nr. 9048, date 07.04.2003           | “Per Trashegimine Kulturore”, i ndryshuar. Ky ligj ka per qellim shpalljen dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore ne territorin e Republikës së Shqipërisë   |
| <b>Vendime te Keshillit te Ministrave</b> |  |
| VKM 686, date 29.7.2015                   | Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”               |
| VKM Nr. 912, date 11.11.2015              | “ Per Miratimin E Metodologjise Kombetare Te Procesit Te Vleresimit Te Ndikimit Ne Mjedis”   |
| VKM Nr.123, date 17.2.2011                | Per miratimin e planit kombetar te veprimit per menaxhimin e zhurmave ne mjedis.   |
| VKM Nr. 587, date 7.07.2010               | Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike.  |
| VKM Nr. 676, date 20.12.2002              | Per shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror   |
| VKM Nr.804, date 4.11.2003                | Per miratimin e listes se specieve te flores shqiptare qe vihen ne mbrojtje.   |
| VKM Nr. 177, date 31.3.2005               | Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese.  |
| VKM Nr.435, date 12.09.2002               | Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republikën e Shqipërisë.   |
| VKM Nr.803, date 4.12.2003                | Per standardet e cilesise se ajrit.  |
| VKM Nr.994, date 02.07.2008               | Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin.   |
| VKM Nr.114, date 27.01.2009               | Per marrjen e masave emergjente, per permiresimin e situates se sigurise dhe te veprimtarive ne instalimet, qe sherbejne per depozitim transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre. |
| VKM Nr. 271, date 6.4.2016                | “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr. 408, date 13.5.2015, te Keshillit te Ministrave, “Per miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit”, te ndryshuar.   |
| VKM Nr. 408, date 13.5.2015               | “Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit”  |
| VKM. Nr. 671, date 29.7.2015              | “Per miratimin e rregullores se planifikimit te territorit”  |
| VKM Nr. 502, date 13.7.2011               | “Per miratimin e rregullores uniforme te kontrollit te zhvillimit te territorit  |
| <b>Udhezime dhe Rregullore</b>            |  |

|                                      |   |
|--------------------------------------|---|
| Udhezimi Nr. 1037/1, date 12.04.2011 | Per vleresimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore   |
| Udhezimi Nr. 8, date 27.11.2007      | Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara   |
| Udhezimi Nr. 6527, date 24.12.2004   | Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotës të ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menyrat e kontrollit te tyre. |

## 12.2 Qellimi, objektivat dhe metodologja e ndekur per hartimin e VNM-se

Qellimi i metodologjisë se hartimit te VNM-se eshte te siguroje një mjet menaxhimi per procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe te lehtesoje realizimin e një procesi eficient te VNM- se .

Qellimi final eshte te siguroje një nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, nepermjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis nga projekt propozimet, para dhenies se lejes se zhvillimit, te garantoje një proces te hapur vendimarrjeje, pershkrimin e vleresimin e ndikimeve negative mjedisore ne kohen e duhur dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara.

Qellimi i VNM-se eshte te siguroje informacion per vendimmarresit dhe per publikun mbi pasojat mjedisore te zhvillimeve te reja te propozuara.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikoje ndikimet e mundshme negative mjedisore gjate zhvillimit te projektit duke marre ne konsiderate:

- Te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficiente;
- Te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- Te vendosen kushtet per ndertimin;

Ky rapport i Vleresimit te N dikimi te Mjedis bazuar ne qellimin e projektit eshte hartuar:

- Te jape informacion mbi vendndodhjen e sheshit te projektit dhe te analizoje tiparet mjedisore;
- Te jape informacion mbi projektin teknik, per fazen parapregaditore, te ndertimit dhe rehabilitimit
- Te vleresoje ndikimet e mundshme ne mjedisin perreth dhe ne banoret e zones ku do zhvillohet projekti.
- Te pershkruaje masat per reduktimin apo evitim e impakteve te analizuara;
- Te hartoje planin per monitorimin e mjedisit per te mbajtur nen kontroll ndikimet
- Te informoje institucionet vendore, komuniteten dhe grupet e tjera te interesit per zhvillimin e projektit;
- Te nxjerre konkluzione dhe rekomandime mbi rendesine e projektit ne lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rendesine sociale te tij.

Objektivat e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis perfshijne percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejt mjedisore gjate zbatimit apo mos zbatimit te projektit.

Ndikimet mjedisore te projektit do te vleresohej ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e implementimit te ketij programi.

## 13 NDERHYRJET NE PLANIN E RRUGES

Ajo qe vlen per te theksuar eshte se ky aks nuk prish asnje banese apo godine tjeter funksionale. Meqenese gjurma e re do te zhvillohet me shume ne krahun e majte te rruges ekzisuese edhe nderhyrjet me te medha ndodhen ne kete krah. Keto nderhyrje jane te kategorizuara si me poshte:

1. Prishje mure rrethuese me gjatesi 408 m
2. Prishje gardhe rrethues me gjatesi 121m
3. Spostim shtylla elekrike ne total 13 copë
4. Prishje pusetash 9 copë
5. Porta objektesh qe spostohen 12 copë
6. Kasete uji te pijshem qe spostohen 8 copë
7. Siperfaqje te betonuara qe prishen 330 m<sup>2</sup>

Me poshte po paraqisim planimetrine e nderhyrjeve:



**Figura 15 – Planimetria e nderhyrjeve**

**14 VLERESIMI I KOSTOVE****14.1 Te pergjithshme mbi hartimin e nje preventivi**

**Kostot njesi per preventivin.** Secilit prej komponenteve i eshte caktuar nje kosto njesi sic tregohet ne preventiv. Kosto totale eshte shuma e produkteve te sasive shumezuar me kostot njesi korresponduese. Metoda e cmimit njesi eshte e drejtperdrejte ne princip por jo e lehte ne aplikim. Hapi fillestar eshte te zberthehet nje proces ne nje sere detyrash. Bashkerisht, keto detyra duhen perfunduar per ndertimin e nje faciliteti. Sapo keto detyra te jene percaktuar dhe sasite qe percjellin keto detyra te jene caktuar, nje kosto njesi i caktohet seciles dhe pastaj kosto totale llogaritet nga shumatorja e kostove per secilen detyre. Niveli i detajimit ne shperberjen e detyrave do te ndryshoje ne menyre te konsiderueshme nga nje vleresim ne tjetrin.

**Alokimi i kostove te perbashketa.** Alokimi i kostos nga vlerat ekzistuese mund te perdoret per te gjetur koston e nje operacioni. Ideja baze ne kete metode eshte qe cdo zeri shpenzimi mund ti caktohen karakteristika te vecanta te operacionit. Ne menyre ideale, alokimi i kostove te perbashketa duhet te lidhet rastesisht me kategori te kostove baze ne nje proces alokimi. Megjithate, ne shume raste, nje lidhje e rastesishme ndermjet faktorit te alokimit dhe kostos se nje zeri nuk mund te ekzistoje ose nuk mund te gjendet.

Cmimet njesi te perdorura per vleresimin e kostos jane marre nga Manuali i Ndertimit ne Shqiperi si dhe nga analizat e reja te cmimeve ( te perpiluara ne baze te cmimeve te ketij manuali ose ne baze te vleres me te ulet te 3 ofertave nga tregu).

Ne rastin e punimeve qe duhen perfshire ne llogaritje por qe nuk gjenden ne Manualin Zyrtar Shqiptar te Ndertimit, eshte e nevojshme te vazhdohet me analiza te cmimeve te reja/cmimeve njesi.

Analiza e cmimeve mund te percaktohet si studim analistik (sasiore dhe cilesore) qe con ne percaktimin e nje cmimi te ri njesi te nje zeri pune, duke identifikuar komponentet e tij elementare.

Per te caktuar cmimin e nje zeri te vetem, duhen kryer analiza cmimesh te kujdeshme duke identifikuar elementet nga perbehet zeri.

Pergjithesisht komponentet elementare jane si me poshte:

1. Fuqia punetore (Puntoria)
2. Transporti
3. Makinerite
4. Materialet
5. Shpenzimet e plotesuese dhe fitimi

**Fuqia punetore**

Kostoja e **fusqise punetore** percaktohet nga lloji i punetoreve dhe oret e punes qe nevojiten, sipas Manualit te Ndertimit ne Shqiperi.

**Transporti**

Kostoja e **transportit** percaktohet nga lloji i makinerive dhe oret e punes qe nevojiten, sipas Manualit te Ndertimit ne Shqiperi.

### **Makinerite**

Kostoja e **makinerive** percaktohet nga lloji i makinesive dhe oret e punes qe nevojiten, sipas Manualit te Ndertimit ne Shqiperi ose ne baze te vleres me te ulet te 3 ofertave nga tregu.

### **Materiale**

Kostoja e materialeve percaktohet nga lloji i materialeve, sipas Manualit te Ndertimit ne Shqiperi ose ne baze te vleres me te ulet te 3 ofertave nga tregu.

### **Shpenzimet plotesuese dhe fitimi**

Shpenzimet plotesuese dhe fitimi jane kostot qe percaktohen mesatarisht me nje perqindje fikse kundrejt shumes totale te elementeve te përshtuar me siper (fuqi puntore, transport, makineri dhe material), perkatesisht 8% per shpenzimet plotesuese dhe 10 % per fitimin. Shpenzimet plotesuese perfshijne:

- magazinim
- mobilizim
- menaxhimi administrativ dhe organizativ
- impiante
- matje te ndryshme dhe verifikime
- Te tjera

## **14.2 Formati i preventivit**

Ne perpilimin e preventivit eshte ndjekur format / modeli i rekomanduar nga Bashia Tirane.

Nen kapitujt kryesor te preventivit jane:

1. Punime dherash
2. Punime te shtresave rrugore
3. Punime per Trotuaret
4. Punime ne kanalizimet e ujrale te bardha
5. Punime ne kanalizimet e ujrale te ndotura
6. Punime te ndricimit Rrugor
7. Punime per rindertimin e mureve rrethues
8. Punime sinjalistike

Sipas kerkesave te fundit ligjore preventivi i punimeve eshte hartuar ne plafomen elektronike e-albania.